

BIBLIOTEK
SHTETIT

SH-14-2

684

LIRIKA
ANTIKE
GREKE



877.0-4-822

8H-14-822


L 84

LIRIKA ANTIKE GREKE



I përktheu nga origjinali

Henrik Lacaj



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

Redaktor

SHPËTIM ÇUÇKA



Handwritten text or signature, possibly a date or initials, located in the lower right quadrant of the page.

PARATHËNIE

Asnjë letërsi tjetër në botë ndofta nuk është zhvilluar në mënyrë kaq të harmonishme e në vazhdimësi logjike sa letërsia e Greqisë së lashtë. Kjo ndodhi se dhe etapat, në të cilat u zhvillua shoqëria, u dalluan mirë njëra nga tjetra dhe nuk precipituan si në Romë.

Procesi i zhvillimit të botës greke ishte i gjatë. Që nga rendi fisnor deri në vendosjen, lulëzimin dhe shkatërrimin e rendit skllavopronar kaluan gati dymijë vjet. Gjatë kësaj kohe një letërsi dhe art i madh muarën jetë, që u ushqyen në burimin e begatë të mitologjisë, e cila siç thotë Marksi, përbënte jo vetëm arsenalin e artit grek, por dhe truallin e tij. Dhe koherencën dhe vazhdimësinë në letërsinë dhe artin grek e krijoi mitologjia.

Dhe në se do të hartohet një fjalor mitologjik, ky do të shterronte me veprën poetike të Homerit. Prandaj «Iliada» dhe «Odisea» mbetën burim i pashteruar frymëzimi për antikitetin grek.

Eskili thoshte se tragjeditë e tij janë thërrime të tryezës homerike. Dhe Eskili jetoi rreth katër shekuj më vonë se Homeri.

A Aty nga mesi i kësaj periudhe katërqindvjeçare lindi dhe u zhvilluan një gjini e re — lirika. Edhe kjo i lagu buzët në burimet e freskëta të Olimpiti, sepse trimërinë dhe virtytin, dashurinë dhe verën që ajo këndoi, pati kënduar dikur edhe Homeri.

Rrodhën shekujt dhe kushtet politike e shoqërore të Greqisë ndryshuan shumë. Zhvillimi ekonomik i qyteteve-shtete në qindvjeçarët VIII, VII dhe VI para erës së re sollën shkatërrimin e mbretërive dikur plot zulm të epokës heroike, që këndoi «Iliada dhe «Odisea», që u fikën me radhë njëra pas tjetrës, për t'i lënë vëndin lindjes së një shoqërije të re me qytetarë të lirë dhe skllever. Në këtë kohë u rritën mjaft qytetet (poliset). U shkatërruan kështu lidhjet e vjetra të fisit dhe vëndin e zuri shoqëria e re, e organizuar në shtet, shoqëria skllavopronare, e para në historinë e njerëzimit me klasa antagoniste. Zhvillimi i tregëtisë dhe i zejtarisë e shpejtoi edhe më shumë procesin e diferencimit social-ekonomik. Një ilustrim të këtyre dukurive të reja na japin vjershat e poetit të shekullit të VI Teognidit. Duke qënë vetë një aristokrat i shkatërruar ekonomikisht ai mban një qëndrim plot urrejtje ndaj njerëzve nga populli që janë pasuruar, të cilët siç thotë ai, jo shumë kohë më parë, të veshur me lëkurë dhish kullosnin si drerë jashtë portave të qytetit, kurse tani qënkan bërë fisnikë.

Lufta e popullit (e demosit) kundër fisnikëve të lashtë që hyri në historinë e Greqisë si lufta e demokracisë me aristokracinë, ishte e ashpër dhe e vazhdueshme. Aristokracia fisnore nuk donte të hiqte dorë vullnetarisht nga sundimi i saj dhe me dëshpërim u qëndronte sulmeve të forcave të reja.

Por demokracia që u vendos në qytetet-shtete të Greqisë pas shkatërrimit të aristokracisë fisnore ishte një demokraci për pakicën e pasur, sepse shumica dërrmuese e popullsisë jetonte me frikën e së nesërme dhe të urisë dhe nuk gëzonte asgjë prej saj veç lirisë formale. Pozitën sunduese në shoqëri e zinte klasa e skllapronarëve, ku futeshin pronarët e tokave, të punishteve, të zejtarisë, që shfrytëzonin egërsisht punën e skllevërve, si dhe tregëtarët e pasur, fajdexhinjtë e të tjerë. Kurse shtresat e gjera të popullsisë të ashtuquajtur të lirë po shkatërroheshin ekonomikisht dita ditës, binin viktimat të konkurrencës së prodhimit të madh të skllavopronarit, të borxheve të shumta dhe të fajdexhinjve, humbisnin edhe ndonjë pronë të vogël që mund të kishin, ose detyroheshin të linin atdheun për të rregulluar jetën e tyre në kolonitë, a të bëheshin mercenarë në ushtrinë e ndonjë vëndi të huaj. Gjendjen e mjeruar të njeriut të thjeshtë të popullit kundër parisë së etur për plaçkitje dhe pasuri e gjejmë që te Homeri, vënë në gojën e Tersitit, megjithëse jemi në një shoqëri ku nuk ka ende klasa dhe shtet.

Procesi i diferencimit shoqëror në Greqi ishte mjaft i gjatë dhe i ndërlikuar. Me formimin e qyteve-shtete klasat zunë pozicione të qarta në luftën

midis tyre, e cila do të zhvillohet në fillim midis demosit (popullit) dhe aristokracisë dhe pastaj midis shtresave të varfëra dhe të pasura brënda për brënda demosit.

× Shtypja dhe shfrytëzimi u bë tipari themelor i shoqërisë skllavopronare, dhe poeti e ligjëvënësi Solon në një vjershë të tij i padit ata.

që marrëzisht po duan ta fikin fare
t'madhin qytet, sepse synojnë te kamja
krerët e tyre nuk kanë shpirt të pastër
.....

dhe vjedhin si hajdutë dikush andej
dikush këtej.....

Ndryshimet ekonomike në shekujt VIII dhe VII para erës së re sollën në shoqërinë greke interesa të reja. Mëndja kureshtare e njeriut nisi të kërkonte baza të reja jetese, të nxirrte përfundime nga vëzhgimet mbi dukuritë e natyrës dhe të shoqërisë e të grumbullonte rregullat dhe normat e nxjerra nga përvoja dhe mënçuria njerëzore...

× Në ndryshim me pikëpamjen aristokratike ndaj punës si diçka e ulët për fisnikët, tani i këndohet forcës dhe dobisë së saj:

Jo, asnjë punë s'është turp, turp
është të mos punosh.

Hesiodi e këshillon të vëllanë të punojë

... në qoftë se s'dotë shkosh si lypës
në derë të huaj...

Ky mendim përshkon si një pe i kuq poemën e Hesiodit «Punët dhe ditët», vepër kjo me karakter didaktik, që pasqyron marrëdhënje të reja, koncepte të lindura nga nevojat e jetës së përditëshme dhe që nuk bën pjesë në lirikën e mirëfilltë.

Poeti jep në veprën e tij «Punët dhe ditët» një radhë këshillash praktike dhe parashtron në mënyrë sistematike përvojën e grumbulluar gjer në atë kohë mbi jetën dhe veçanërisht mbi punët e bujqësisë. Flet për përgatitjet që duhen bërë para mbjelljeve e korrjeve, për lërimin e tokës, për sigurimin e bazës materiale, për kafshët e punës:

*Dy demat të jenë meshkuj nëntëvjeçarë,
se atëhere fuqinë e kanë fare të freskët.*

e deri dhe për drurët që duhet të shërbejnë për të ndërtuar këtë apo atë pjesë të përmëndës:

*timoni t'jetë dafine ose vidhi,
që s'preket as nga mola, kurse cungu
të jetë prej lisi...*

Shpesh mendimet e poetit të shprehura në formë këshillash marrin ngjyrën e fjalëve të urta e të aforizmave: Punët mos i le për nesër e pasnesër, ose Njeriu që vazhdimisht i shtyn pra punët, s'e mbush hambarin kurrë. ↗

Koncepti mbi të mirat e punës hap rrugën e përpjekjeve për çlirimin e mendjes dhe të shpirtit nga paragjykimet e lashta të kastës. Njeriu tani do të çmohet jo për prejardhjen shoqërore po për vle-

rat dhe meritat e tij: ç'rëndësi ka të jenë prej fisi t'largë,/ ata të cilët s'kanë kurrfarë njerëzije/ ndër fjalë edhe në mendje — këndon Fokilidi.

Morali i ri i shoqërisë e frymëzon Simonidin nga Amorgu të flasë me neveri për gruan përtace (aristokrate dhe të pasur) që as mokër, jo, as sitë nuk prek me dorë, dhe të lavdërojë atë që i ngjan bletës punëtore:

Si lum ai që e mori këtë femër

Lindja e shoqërisë së re skllavopronare solli përparime të dukëshme në lëmin e filozofisë dhe të shkencës. Nisi të studjohej mbi baza shkencore natyra në tërë dukuritë e saj dhe të mbahej një qëndrim skeptik ndaj sistemit mitologjik të Olimp:

.....as Zeusi
nuk u pëlqen të gjithëve as atherë
kur bie shi, as kur s'e le të bjerë
(Teognidi)

apo të vihet në dyshim drejtësia e hyjnive:

*qysh duron urtia jote
o djalë i Kronit, që njeriu i mbrapësht
të këtë të njëjtin fat që ka dhe i drejti.
(Teognidi)*

Me një notë tronditëse realiste poeti i hallëve të popullit Hiponakti flet për varfërinë e tij

dhe ankohet se Pluti, perëndi e pasurisë, «ai qorr qorri» s'i ka shkelur në shtëpi poetit për t'i dhënë «tridhjetë para të argjëndta.»

Për herë të parë lind ideja se bota materiale nuk ka fund në kohë dhe në hapësirë, se njeriu nuk është krijesë e fuqive hyjnore, por përkundrazi perënditë janë krijesë e fantazisë së njeriut. Që në këtë çast lindi lufta midis materializmit dhe idealizmit, midis dialektikës dhe metafizikës...

Zhvillimi i filozofisë dhe i shkencës, tregëtisë dhe i lundrimit në Greqi, kontakti me popuj dhe vende të ndryshme, të gjitha këto lindën nevojën për të përjetësuar në shkrim ngjarje historike, përshlyetje udhëtimesh, ligje, zakone, urtësinë dhe përvojën e jetës së popullit. U dukën kështu logografët dhe fabulistët e parë (Ezopi), që përmes personazheve kafshë vunë në shenjën e satirës vese dhe plagë të shoqërisë së re.

✓ Letërsia e re që lindi në këtë kohë bëri objekt të pasqurimit tema dhe motive nga jeta e përditshme, botën e brendshme të individit, me interesat dhe pasionet e tij, në ndryshim nga eposi i lashtë, që shprehte ndjenjat dhe idealet e një bote tanimë të perënduar.

Gjinia që lulëzoi si në asnjë vënd tjetër në lashtësi është poezia lirike, e cila së bashku me poezinë epike dhe atë dramaturgjike shënoi kulmin më të lartë të letërsisë klasike greke.

U quajt lirike nga emëri i veglës muzikore (lyra), me të cilën shoqëroheshin poezitë e kënduara nga një njeri (lirika monodike), apo nga shumë njerëz (lirika korale). Rruga nga poezia epike

në poezinë lirike ishte e gjatë por jo dhe krejt e panjohur. Poezia lirike në kuptimin e poezisë subjektive, që na jep me natyrshmëri mendimet dhe ndjenjat e poetit ishte e njohur dhe e kultivuar dhe më parë në fisin e akejve. Dëshmi të sigurtë për këtë gjejmë edhe në poemat e Homerit. Kur poeti përshkruan në mburojën e Akilit figurën e një fëmije që «i binte ëmbël qestes,/ e lehtë me zë këngën e Linit merrte», ka parasysh një episod nga jeta reale e kohës së tij, kënga e trishtuar që vajtonte fundin e parakohshëm të fëmijës Lin. Ksombla të këngës lirike elegjiake gjejmë edhe në vise të tjera të «Iliadës» (vajtimi i Andromakës dhe i prindërve mbi kufomën e Hektorit).

Sidoqoftë lirika arkaike ishte shumë e lidhur me botkuptimin mitologjik dhe me rite të ndryshme fetare. Natyrisht këngët e punës e të dasmës, këngët e përmortshme dhe fetare shprehnin diçka nga bota e brëndshme e njeriut, por ato gjithsesi përmbanin në vetvehte elementë të botkuptimit të kohës dhe i takonin më shumë folklorit dhe jo lirikës individuale të kultivuar.

Lirika individuale lindi vetëm atëhere kur u duk poeti individual, kur njeriu nisi të bëhej i vetëdijshëm për personalitetin e tij të lirë, pas rënies së bashkësisë primitive të fisit.

Lindja e pronës private dhe e inisjativës personale u pasqyrua edhe në mënyrën e shprehjes të ndjenjave dhe mendimeve të njeriut. Në vënd të paraqitjes së botës ideale të hyjnive dhe të heronjve të këngëve të lashta epike, vendin kryesor tani e zë subjektivizmi, në vënd të botës së fantazisë

— realiteti i gjallë, në vënd të së kaluarës së lashtë — jeta aktuale.

Por edhe në këtë fushë trajtu e re e ndërgjegjes shoqërore nuk u shfaq me njëherë dhe kjo u duk edhe në poezi. Një pjesë e lirikës greke priret ende nga eposi. Dhe po të ndjekim vazhdën e zhvillimit të poezisë lirike vërejmë se belbëzimi i parë i saj është një kushtim për luftë.

Aty nga gjysma e shekullit të VII para erës së re kishin shkelur në pragun e botës helene fise dhe popuj barbarë, të cilët po kërcënonin lirinë e qyteteve — shtete të Greqisë. Dhe poeti i lashtë Kalin u kujton bashkëqytetarëve rrezikun që po u kanoset dhe i fton të rrokin armët:

Secili

le të luftojë gjer te shigjet' e fundit,
se për një burrë është nder edhe lavdi,
kur për atdhe, për grua dhe fëmijë
lufton kundër armikut.

x

Në ndryshim nga epoka homerike, ku për të mbrojtur trojet dhe vatrat e tyre luftojnë vetëm trojanët, tani nocioni për atdheun bëhet më i përcaktuar. Dhe tema e mbrojtjes dhe e dashurisë për të do të zërë një vënd të rëndësishëm në lirikën greke.

Nuk paska gjë më t'ëmbël se atdheu

këndon Teognidi.

X
Atdheu si nocion tani nis e konkretizohet nga faktorë ekonomikë, një arsye më tepër kjo për ta mbajtur qytetarin të lidhur fort pas tij, sepse siç thotë Tirteu, ai njeri që

braktis atdhe e tokë pjellore
.....endet andej-këtej
duke shtrirë dorën, krejt i
dërmuar skamje dhe mjerimi.

X
Më vonë me kushtrimin për luftë në mbrojtje të atdheut dhe të familjes do të bashkohet zëri i Alkeut, i Safos, i Anakreontit, i Simonidit e të tjerëve, duke forcuar edhe më tepër notën realiste aktuale të poezisë, e cila do të pasurohet me tema dhe motive të reja. Realiteti i ri shoqëror do të derdhet me të gjitha hijedritat e tij në vargjet e skalitura të poetëve grekë të shekujve VII dhe VI.

Përmes një lirizmi të hollë dhe thjeshtësisë sugjestive do të shprehen mendime dhe ndjenja të përjetuara nga poeti.

Por lirika greke u zhvillua jo me të njejtat forma dhe ngjyra në tërë trevat e Greqisë...

Nësa poezia lirike që u zhvillua në Joni kishte përgjithësisht përmbajtje didaktike, që ftonte lexuesin për veprime të mira, për punë të rëndësishme e të virtytëshme, kurse ajo që u zhvillua në fiset dorike mori formën e lirikës korale, e cila më shumë nga të gjitha llojet e tjera mbajti lidhje të ngushta me kultin dhe ritet e ndryshme dhe u shërbeu kryesisht këtyre, në vjershat e poetëve të shkollës poetike eoliane, Alkeut dhe Safos, momen-

ti subjektiv u shpreh më qartë dhe më me elegancë.

Poezia korale, e kënduar nga një grup njerëzish, në mes të popullit dhe në vende publike, shprehte ndjenja, mendime, dëshira të përbashkëta për tërë qytetin. Individualizmi, karakteristik për komunitetin e eolëve, te dorët nuk gjeti kushte politike për t'u zhvilluar. Fisi i dorëve i ruajti për një kohë më të gjatë traditat aristokratike e luftarake, paragjykimet e lashta të kastës dhe feja tek ata ushtroi një ndikim më të madh se në fiset e tjerë helenë. Kjo bëri që jeta private t'i nënshtrohej jetës publike dhe individi të jetonte i tëri me interesat e komunitetit,.. Dorët u treguan më të përmbajtur në shprehjen e ndjenjave personale. Me rastin e festave popullore fetare, të procesioneve solemne në dasma e në funerale, korët e tyre madhështore ushtonin nëpër rrugët e qyteteve duke shprehur ndjenjat dhe mendimet e përbashkëta qytetare.

Grekët ishin shumë të ndijshëm ndaj melodi-ve muzikore, që kanë qenë shumë të larmishme në Greqi... Kjo përcaktoi dhe harmoninë e melodiozitetin e lirikës në përgjithësi në dy drejtimet e saj kryesore.

Pindari, poet aq sa dhe muzikant, përfaqësuesi më i madh i lirikës korale, në këngët e tij e veçanërisht në epiniket, glorifikoi me tone të ngritur e madhështorë fitoren e atletëve në garat gjimnastikore të Olimpies, Delfit, Nemesë dhe Korintit dhe duke marrë shkas prej tyre shpërthente në botën e mitologjisë me një fuqi të mahnitshme përgjithësu-

ese mbi virtutin, bukurinë morale e fizike të njeriut si mishërim i idealit të kohës.

Nësa Pindari shprehu qëndrimin e tij ndaj realitetit në mënyrë impersonale e të tërthortë, Alkeu, përfaqësuesi i lirikës monodike eoliane u shpreh drejt për së drejti e në mënyrë tepër personale.

Poezia e Alkeut u bë pasqyrë e jetës së tij. Vala e përlëshjeve politike, që u zhvilluan të ashpëra në qytetin Mitilenë të Lesbosit, përfshiu në vorbullën e saj edhe poetin. Luftrat e vazhdueshme kundër tiranëve, hallet e mërgimit nga atdheu, gjetën shprehjen e tyre në vargjet e shkruara me një shqetësim nervoz e me shpërthime të shpesh-ta, plot thirrje dhe evokime të kohëve heroike për të rrokur armët e për të luftuar.

«me burrërinë e etërve trima
që dergjen poshtë nën dhe,

Por me kushtimin për luftë dhe me ndjenjën e urrejtjes klasore përzihen te Alkeu tingujt e gëzueshëm të jetës, thirrja që u bën miqve për të shijuar dashurinë dhe verën:

«Pi Melanip e dehu bashkë me mua»

Poeti hedh poshtë paragjykimet mbi botën e përtejme. Ai e fton mikun ta heqë mëndjen se mund të shohë përsëri

«rrugën e pastër t'diellit»

pasi të ketë kaluar «tej Akerontit që valon me gjire.»

Thirrja për të gëzuar jetën në të gjitha shfaqjet e saj e forcoi edhe më notën realiste të poezisë lirike, frymëmarrja e së cilës u bë më e lirë dhe u shtri deri në fshehtësitë gjer atëhere të panjohura të psikes njerëzore. ✕

Edhe më fuqishëm tingëllojnë optimizmi dhe kënaqësitë shqisore në poezinë e Anakreontit, të këtij këngëtar i ashik që jeto i mbi tetëdhjetë vjet, që digjet nga dashuria dhe që kërkon ta shijojë jetën si dikur në rini.

Ky «këngëtar i lashtë klasik i dashurisë» (Engelsi) u bë simboli i poezisë erotike dhe objekt i imitimeve të shumta në antikitetin e vonë.

Bota greke, e kthjellët dhe poetike, e lirë nga misticizmi dhe dogmat kristiane, e shikon dashurinë si një ndjenjë të natyrëshme, si forcë rikrijuese e përtëritse. ✕

Petrarka, poeti i shquar i Rilindjes italiane, e sheh dashurinë si ngasje të djallit dhe i lutet zotit ta shpëtojë nga rrjeta mëkatore, ku është kapur, kurse Anakreonti dy mijë vjet më parë, kapet në rrjetë jo nga demoni, por nga një grua e bukur reale. Afrodita hyjneshë e dashurisë, që është aq njerëzore sa dhe vetë ndjenja që provon poeti:

Vjen e m'hedh një top të purpurt,
ai Erosi, flokët ar,
dhe më fton që të mahitem
me një vashë sandalelarme.

Një transparencë e ngrohtësi të veçantë gjen ndjenja e dashurisë në vargjet e poeteshës më të madhe të antikitetit Safos nga ishulli Lesbos. Lirika e saj thellësisht subjektive, plot emocione e shqetësime për shkak të dashurisë, xhelozisë dhe mallit të largët, shquhet për thjeshtësinë, për harmoninë e ëmbëlsinë e vargut, për larminë e madhe të metrave dhe të mjeteve shprehëse.

Në ishullin Lesbos, ku fisi i lashtë grek i eolëve kishte arritur një shkallë të lartë kulture e qytetërimi, motivet e lashta të ritit, të kultit, të dasmës etj. me Safon arritën nivelin më të lartë të shprehjes poetike.

Asgjë nga bota mitologjike, që u bë pjesë e pandarë e poezisë dhe e jetës shpirtërore të grekut të lashtë, nuk i intereson Safos veç asaj që është njerëzore, dhe që i shërben të zbulojë pasionet e saj. Këndej kuptohet se bota e së parës poeteshë romantike në letërsinë botërore është mjaft intime. Ajo është kaq thellë e futur në të sa nuk ka kohë të mendojë, por e lë veten të rrëmbehet nga pasioni i dashurisë, i cili i errëson gjykimin:

pse, duke t'parë, mua asnjë fije zëri s'më
vjen te buza,
gjuha më pritet edhe n'ato çaste
se ç'më gjarpëron një zjarr i hollë ndër
dejë,

ia errëson pamjen:

Sytë nuk më shohin dhe brenda veshëve
më zien oshëtima

Këto gjendje psikologjike do t'i huazojnë më vonë Katuli, Danteja, Petrarka etj.

Përjetimet e poeteshës nuk arrijnë të marrin formë moralizuese si te pjesa më e madhe e poetëve grekë. Nga goja e saj nuk del kurrë një fjalë e urtë, një sentencë.

Sensibilitetin poetik të Safos e gjejmë në aftësinë të dëgjojë zërat e panumurta të natyrës, të shohë ngjyrat më delikate e më të këndëshme të saj për të krijuar me të gjitha këto një harmoni melodioze tingujsh, e rrallë në poezinë greke.

Me një stil tepër lapidar, vetëm në tre vargje në vjershën e «Mbrëmjes» poetesha ka dhënë në çastin më pasiv të ditës aq shumë dinamikë dhe hapësirë jete: përmes një kuadri të mbushur me mallin dhe ngrohtësinë familjare shpaloset motivi i veprimtarisë njerëzore, i natyrës dhe i dashurisë - prindërore.

Shumë të njohura janë epitalamet e Safos. Me stilin e tyre të një sensibiliteti të hollë ato na kujtojnë këngët popullore të dasmës me momentet e njohura: molla në majë të degës (nusja), vjelësit që nuk dihet e kanë harruar apo nuk kanë mundur ta këpusin (mtonjësit) etj.

Një vënd me rëndësi do të zërë natyra në poezinë klasike greke. Peisazhi i shërbeu dikur Homerit si mjet për të gjallëruar parafytyrimet mbi tablotë epike të luftës, Hesiodit për ta bërë edhe më të dashur punën e bujkut dhe të blegtorit, ndërsa për poetët lirikë të periudhës klasike, natyra me bukuritë e saj mahnitëse u shndrrua në element botëkuptimor. Ajo nuk u bë një mjet ekzaltimi dhe

lektisjeje si tek romantikët, por një rreze që hodhi më tepër dritë në dashurinë për jetën dhe mënjanoi figurat e hyjnive, të cilët mbetën në poezi, pavarësisht bindjeve të brëndëshme filozofike, si dekor poetik dhe shkas frymëzimi. Edhe në vjershën kaq të bukur «Vajtimi i Danaes» të Simonidit miti ka humbur kuptimin e tij të mirëfilltë dhe ka shërbyer për të endur dramën kaq njerëzore të nënës që dridhet për fatin e të birit. Antropomorfizmi i Greqisë së lashtë që i percepton hyjnitë sipas fytyrës së njeriut, me të gjithë virtytet dhe dobësitë, me pasionet dhe ndjenjat e tij, e shpëtoi poezinë nga asketizmi dhe misticizmi i mitologjive të Lindjes, ku perënditë përfytyrohen si qenie të frikëshme të përbindshme. Kjo i dha artit të mrekullueshëm grek dritë dhe ajër, e bëri atë aq njerëzor e të tejdukshëm në thjeshtësinë e tij të mahnitshme.

Natyra te poetët grekë është shprehje e harmonisë së gjithësisë dhe shikohet prej tyre si botë materiale që nuk ka fund në kohë dhe në hapësirë. Ajo është frymëzuese e zërit të brendshëm poetik dhe e melodiozitetit.

Të tillë fjalë edhe të tillë muzikë Alkmani e gjeti duke imituar klithmën e thellëzave, të shprehur në fjalë, — shkruan Alkmani në «Kënga e thellëzave».

Lulet, shpendët, ujrat, dielli, hëna, yjet vënë në lëvizje ndjenjën poetike dhe shërbejnë për të krijuar gjendje të veçantë psikologjike (Natë e vetmuar — Safo), apo paralelizma figurative (E bukura e largët — Safo; Kënga e pranverës — Ibiku).

Natyra shpesh shërben si një nënkrejcë ku

mbështet kryet bota e lodhur nga hallet për të gjetur paksa qetësi. (Natë e qetë — Alkmani).

Edhe kur në ndonjë poezi lëvizin qenjet mitologjike (Kupa e diellit Stesikori) ato në gjirin e natyrës, më shumë se kudo, bëhen aq njerëzore sa humbasin çdo element hyjnor...

Filozofikisht një vështrim i tillë është një hap drejt panteizmit.

Sidoqoftë natyrës në poezinë greke nuk iu këndua si një oaz për të shpëtuar nga të këqijat e qytetit, nisur nga pozita të caktuara politike e sociale siç ndodhi me poezinë latine. Idetë filozofike, sociale, etike të lirikës greke nuk arritën të organizoheshin në një sistem pikëpamjesh. Kjo për arsye se lirika greke u zhvillua në fillimet e vendosjes së shoqërisë skllavopronare, e cila në atë kohë ishte ende e pagërryer nga kontradikta dhe plagë të thella. Prandaj dhe denoncimi i së keqes është mjaft i përgjithshëm, i paqartë dhe s'merr formën e kritikës së vetëdijëshme historike siç do ta bëjë këtë 5-6 shekuj më vonë poezia në Romë.

Poetët e Greqisë së lashtë kishin një mendim të lartë për poezinë. Ata i kushtonin vëmendje të veçantë përpunimit të frazës poetike gjer në atë pikë sa ajo të bëhej mjet efikas për të përçarur tek lexuesi apo dëgjuesi (me që një pjesë e poezisë këndohej e shoqëruar me vegël muzikore e me kor) ndjenjën e poetit.

Në ndryshim nga poezia romake, pasionale dhe e vrullëshme, poezia greke ruajti gjithnjë një farë ekuilibri midis pasionit dhe kthjelltësisë shpirtërore. Nëse kthjelltësia olimprike në rrafshin filozo-

fik e si rrjedhim edhe në atë të problemeve shoqërore luajti rol negativ, sepse predikonte rezinjatën, në rrafshin psikologjik shërbeu si rregulator për të harmonizuar ndjenjën me arësytën. Edhe te Safoja, poetesha më melankolike dhe më pasionale e Grekisë, që e lë veten të rrëmbehet në vorbullën e një dashurie pa fat, nuk e gjejmë atë trishtim dhe brengë aq të zyrtë si te Katuli, Tibuli e Properci. Edhe pse personale e subjektive lirika greke gazin e jetës dhe të dashurisë e jep në përmasa përgjithësuese e si kategori etike. Këtu zë fill dhe mendimi që poetët kishin për misionin e tyre në jetë. Pindari e krahason poetin e vërtetë me shqiponjën që ndërmjet fluturakëve të tjerë është

më e shpejta e s'largu vëzhgon e ato kthetra ia ngjet vetëtimë presë të vet së përgjakur.

Lirika greke, kuptohet, si gjithë arti në shoqëritë pararendëse, nuk është e çliruar nga kufizimet dhe vështrimi idealist mbi botën. Te përfaqësuesit e saj krahas ideve përparimtare gjejmë elementë të mitologjizmit, prirje për të hyjnizuar aristokracinë tradicionale e për të mbrojtur interesat e saj si klasë (Teognidi, Alkeu, Pindari) etj.

Besimet e lashta fetare dhe kulti i hyjnive të Olimpikut edhe pse në një formë pak të ndryshuar e me një qëndrim të përmbajtur vazhduan të jetojnë deri vonë. Klasa e skllavopronarëve ruajti fenë për të shënjtëruar autoritetin e saj, ligjet dhe institucionet e polisit. Feja olimpike duhej t'i shërbente hierarkisë sunduese për të përligjur bazën klasore të shoqërisë greke, antagonizmin midis padronit dhe skllavit, midis pronarit dhe qytetarit të

varfër, motivin se klasat në fuqi ishin me origjinë hyjnore dhe të paracaktuara nga fati për të sunduar mbi klasat e tjera. Dhe fati për grekët e vjetër ishte një fuqi e pandalëshme që vepronte edhe mbi perënditë.

Vdekja vjen kur ta kenë thënë Fatitë këndon poeti Kalin.

Ideja e fatit në Greqi u vu në themel të doktrinave të ndryshme filozofike dhe të moralit të kohës, që synonte të shuante çdo aspiratë për një jetë më të mirë duke ngulitur te njeriu bindjen se çdo përpjekje do të ishte e kotë. (Tragjedia, «Edipi mbret» e Sofokliut).

↳Përfytyrimin e zymtë dhe pesimist mbi fatin e zbusnin në atë kohë besimi dhe shpresa në hakmarrjen dhe drejtësinë hyjnore.

N'rast se ndokush fiton shumë pasuri,
në daç me dhunë, n'daç me fjalë dinake
.....

hyjnitë shumë lehtë atë njeri e dërmojnë shkruan Hesiodi në «Punët dhe ditët». Poeti thotë se tridhjetë mijë rojtarë të pavdekshëm ka caktuar Zeusi për të vëzhguar punët e njerëzve dhe për të mbikqyrur drejtësinë dhe veprat e padrejta...↳

Edhe sikur e ndjerë dhe e singertë të ishte bindja në fatin apo në drejtësinë hyjnore, e cila përbën një nga kufizimet themelore në botëkuptimin e lirikëve grekë, objektivisht ajo u shërbente klasave në fuqi dhe gjithsesi sanksiononte shtypjen dhe shfrytëzimin.

Teognidi në vjershën «Të zezat e varfërisë» shpëtimin nga varfëria e sheh në vetëvrasje:

Që t'i shpëtosh varfërisë, ia vlen të hidhesh
aty ku është, o Cirn deti më i thellë...

Të tjerë poetë shpëtimin e shohin në fisnikëri-
në shpirtërore të njeriut dhe në përsosjen e tij mo-
rale.

Poezia lirike greke, e selitur me përfytyrimin e
begatë të një populli që krijoi legjendën mbi Or-
feun mitik, i cili me këngën e tij magjepste natyrën,
poezia që vibron në të nëntë telat e lyrës orfeane,
me të gjitha ngjyrat e tingujt, me tërë blunë e nde-
zur të qiellit të Atikës e erërat e kryapura të Egjeut,
me gazin e çelur të Arkadisë e me ëndërrimin e pa-
fajshëm të Perseut, tingëllon me të njëjtin patos
edhe kur u këndon armëve të kryengritësve po ash-
tu dhe luleve e brengës së dashurisë, qetësisë së
mbrëmjes një lloj si kushtrimit për luftë. Që nga
Kalini e gjer te Safoja, muza e dhjetë siç e quajti
Platoni, ajo zbuloi për atë kohë një botë të re ndje-
njash dhe emocionesh të thella të njeriut që posa
kishte nisur të sfidonte me bukurinë e tij mendore
dhe shpirtërore atë ç'ka kishte krijuar aq poetikisht
me fantazinë e tij, botën olimpikë.

Lexuesi ynë, i cili ka pritur me interes mjaft
nga kryeveprat e letërsisë klasike greke, që nga Ho-
meri e deri te Lukiani, do të dijë të çmojë lart edhe
këtë buqetë këngësh që vjen nga thellësitë e she-
kujve për t'i folur me një zë që ruan gjithmonë fre-
skinë dhe bukurinë e tij.

Muzafer Xhaxhiu.

HESIODI

NGA VEPRA «PUNËT DHE DITËT»

GARA TË MIRA E TË KËQIJA

S'ka vetëm një lloj gare përmbi tokë,
garat janë dy. Njeriu i urtë së parës
i thur lëvdata, kurse gara tjetër
përbuzje meriton, se për natyrë
ndryshojnë mes tyre. Dhe në të vërtetë
luftën e prapë sjell njëra edhe grindjen
mizore dhe asnjëri s'e do, por prapë
qiellorët deshën që gara dëmtuese
ta kish te njerëzit dhe ajo një vlerë.
E errta natë e ngjalli garën tjetër
dhe djali i Kronit, që banon n'eter
mes qafave të larta, atë e vendosi
n'rrenjë të tokës. Kjo është shumë më e mirë
për njerëzit, se kjo e nxit përtacin
t'punojë, sepse ai që nuk ka punë
edhe shikon një tjetër, një të kamur,
aty në çast dhe ai i përvishet punës
t'hedhë farën dhe ta ngrehë t'fortë një shtëpi.
Një garë e tillë është një e mirë për njerëzit,
zili ka katrovari katrovarin
dhe këngëtari këngëtarin tjetër.

PUNË E JO GJYQE

O Pers, nguliti n'mendje këto gjëra:
e prapta garë kurrë s'duhet të t'largojë
nga puna për t'u sjellë vërdallë ndër gjyqe,
për t'u përzier nëpër «dava» e grindje.
Sepse s'ka kohë për t'humbur ndër «dava»
edhe ndër grindje ai që në shtëpi
s'i ka gjithnjë të mirat me bollëk
as grurë Demetre, që nga stina n'stinë
e prodhon toka. Kur t'i kesh të gjitha,
aherë mund të hapësh sa të duash
dava e gjyqe kundër kamjes s'huaj.
Por ti ankesë të dytë s'do të më bësh,
këtë herë ne bashkë duhet ta bëjmë pajtimin
me drejtësinë e duhur, që është bija
më e mirë e Zeusit; sepse tanimë
ne mallin e babait e ndamë së bashku
dhe shumë mall më vodhe, më rrëmbeve.
Sepse gjyqtarët njerëz të pangopur,
që arrijnë të nxjerrin dhe vendime t'tilla,
me t'holla ti i ke thyer. Budallenjtë!
s'e dinë se sa vlejnë prasi e mullaga.

Tani, po deshe ti, unë shkurtimisht
me njerëzi, me dituri t'sigurtë
një legjendë tjetër ty mund ta tregoj
dhe ti kuptoje mirë se prej një fisi
e kan' prejardhjen njerzit dhe hyjnitë.
Të parin fis të njerëzve vdektarë
prej ari e gatuan perënditë,
që rrojnë n'amshim. Ata jetuan nën Kronin,
që ish sovran i qiellit, dhe jetonin
njëlloj si perënditë, pa ngashërime,
pa mund, pa hidhërime aty në shpirt;
mbi ta s'rëndonte e zeza pleqëri,
por ashtu t'fortë ndër këmbë edhe ndër duar
pa asnjë t'keqe ata e kalonin kohën
n'gosti dhe vdisnin të mbërthyer n'gjumë.
Dhe midis tyre ishin t'gjitha t'mirat:
toka, që jepte tepë, vetë i blatonte
prodhimet krejt pa mund e me shumicë
dhe njerëzit, të butë e dashamirës,
çdo punë dhe t'mirat e begatshme
mes tyre i ndanin, pasanikë siç ishin
plot me kope, dhe perënditë e lumtura
i donin shumë. Dhe, mbasi pra ky fis
u zhduk nën dhe, tani sipas vullnetit
të Zeusit vetë, kanë dalë demonë të mirë
që rrinë mbi dhe, rojtarë të vdektarëve.
Pra ruajnë mortarët, veprat e mira e t'prapta;
janë të përzier me ajër edhe sillen
nëpër mbarë botën, ndajnë dhe pasuritë,
sepse kanë privilegje mbretërore.
Pastaj zotat qiellorë, zotrues t'Olimpit,
krijuan një fis të dytë, shumë më të dobët,

pra prej argjendi, që me fisn'e artë
s'ngjasonte as nga forma as nga mendja.
Mirëpo fëmija njëqind vjet të plota
rrinte n'shtëpi, koktul e budalla
sa s'bëhet, duke u sjellur si fëmijë
pranë nënës s'dashur. Pastaj, mbasi rriteshin
dhe arrinin në një moshë më t'lulëzuar,
rronin pak kohë dhe nga marrëzia e tyre
pësonin hidhërime shumë të rënda,
sepse nuk ditën të qëndronin larg
nga dhun'e sho-shoqme, as nuk deshën
t'u bindeshin qiellorëve, as t'u blatonin
n'altarë të shenjtë atyre hekatomba.
N'fund Zeusi, i biri i Kronit, i zemëruar,
ata i zhduku krejt nga faqja e dheut,
sepse s'u bënë zotave t'Olimpit
asnjë nderim. Dhe, mbasi u zhduk nga toka
një fis i tillë, ata u quajtën t'Poshtmit,
mortarë të lumtur, n'lidhje me nderimet
ata vijnë n'radhë të dytë, megjithatë
dhe ata e gëzojnë ndonjë nga këto nderime.
Dhe ati Zeus krijoi një fis të tretë
të njerëzve, prej bronzi, krejt të ndryshëm
nga ai i argjendit, fis mizor e i tmerrshëm,
lindur prej frashëri. Ata i donin
veprat e Aresit, t'mbarsura me kuje,
ashtu dhe dhunat, dhe ushqimi i tyre
nuk ishte buka, ata në kraharor
kishin një zemër t'fortë, bash prej diamanti,
ishin pa trajtë, me një fuqi t'pamasë,
nga supet dilnin krahë të thyeshëm,
mbi ato gjymtyrë t'fuqishme, pastaj armët

prej bronzi ishin ndërtuar, vetëm bronzin
 ata punonin, sepse s'ekzistonte
 hekuri i rimitë, po, s'fundi, dhe këta,
 pasi e vun'nën thundër njëri-tjetrin,
 zbritën n't'errtën banesë t'Avernit¹⁾ t'ngrirë
 pa lënë asnjë kujtim; ndonse t'llahtarshëm,
 i mori mortja e zezë edhe e lanë
 dritën e diellit, dritën e shkëlqyer.
 Tashti, pasi, pra dhe një fis të tillë
 e mori dheu në gji, Zeus Kronidi,
 mbi plisat që ushqejnë kushdi sa veta,
 krijoi një fis të katërt shumë më t'mirë
 dhe më të drejtë, një fis hyjnor e t'vdekshëm,
 të quajtur fis heronjsh gjysmëhyjni,
 që rronte përmbi dheun e pafund
 përpara fisit tonë. Por dhe këta
 i shuajti lufta e zezë ashtu dhe grindja
 e urrejtur, ca nën portat e shtatfishta²⁾
 në dheun e Kadmit, ndërsa po luftonin
 për grigjat e Edipit dhe ca t'tjerë
 brenda anijeve përmbi humnerat
 e pambarim të detit kur i çuan
 në Trojë për atë Helenën floklulëzuarën.
 Aherë ata këtu i ndrydhi fare
 i mortjes freri i zi dhe ati Zeus
 u dha jetë e banim larg njerëzimit,
 n'skajet e dheut, shumë larg nga të pavdekshmit.
 N'gjirin e tyre është sovran vetë Kroni.
 Dhe ata me shpirt të pastër nga çdo vuajtje

1) Ferri

2) Teba

banojnë atje ndër ishujt e të lumturve:
 Heronj që e kalojnë me aventura
 pranë honeve të thella t'Oqeanit,
 dhe toka atyre u jep tri herë në vit
 frytet e veta t'ëmbra porsì mjalti.
 Oh, kurrë e kurrë mos t'kisha dalë në dritë
 n'fisìn e pestë, por t'kisha vdekë më parë,
 ose më vonë në dritë unë t'kisha dalë.
 Sepse është fis prej hekuri. Jo, kurrë
 s'do i ndahet vuajtja ashtu dhe vajtimi
 dhe shkatërrimi i plotë, ditë edhe natë;
 ndëshkime t'rrepta zotat do t'u japin.
 Megjithatë do t'ketë diçka të mirë
 përzier me t'zezat. Pastaj këtë fis
 do ta shuajë Zeusi aherë kur edhe foshnjët,
 duke dalë n'dritë, do i kenë tëmthet me thinja.
 Jo, as fëmijët s'do t'lidhen ngusht me prindin,
 as prindi s'do të rrijë më me fëmijë:
 mes tyre armiq do t'jenë dhe mysafirët,
 armik miku me mikun, po as vëllezërit
 s'do t'jenë më miq mes tyre si dikur;
 djali, kur prindërit e tij t'jenë plakur,
 do t'i përbuzë, do t'u bërtasë atyre
 duke u gërthitur me ca fjalë të rënda.
 Të çmendurit! As nuk mendojnë asfare
 t'ua shpërblejnë prindërve t'vet të plakur,
 që foshnje i kan'rritur. Pra e drejta
 do t'jetë nga ana e forcës, dhe qytetet
 mes tyre do t'plackiten, s'do t'ketë vlerë
 më mirësia, fjala e drejtësia;
 më shumë do t'çmohet kush do ta teprojë,
 ai që keq do t'bëjë e di gjithkush,

do t'bëjë drejtësi me kok'të vet.
Dhe s'do t'ketë turp, por njerëzit e prapë
për t'zezë të t'mirit kanë për të përdorur
fjalime të tërthorta e be të rreme.
Me njerëzit e mjerë do t'shoqërohet
Smira dhe gjuha e ulët edhe zemra,
që shumë kënaqet me të keqe t'tjerëve,
syri smirzi. Sedra dhe drejtësia,
duke i mbuluar t'bukurat gjymtyrë
të gjitha ndër mantelat bardhë si bora,
larg nga njerëzimi ashtu larg nga Toka
plot me krahina t'gjera, ikin s'bashku
drejt e n'Olimp mes racës së hyjnive.
Mortarëve do t'u mbeten t'zezat vuajtje
dhe kurrë më s'do t'u ndahen fatkeqësitë.

DHUNA DHE DREJTËSIA

O Pers, dëgjoje drejtësinë dhe kurrë mos e përkrah ti dhunën: që për t'dobtin një e keqe është, dhe i forti, po, dhe ai nuk e duron dot lehtë, por shumë rëndohet nën peshë të saj, aherë kur shkon e ndeshet n'furinë e fajit. Shumë më mirë ia vlen të ndjekësh rrugën tjetër që të shpie te drejtësia: drejtësia n'fund gjithmonë fiton dhe budallai mëson n'kurriz të vet. Se ai «Betohem» bredh ku jepen krejt vendime të padrejta dhe puna e drejtësisë eliminohet, po qe se vetë gjyqtarët e pangopur e zbojnë atë dhe japin një vendim me një gjykim të shtrembër. Dhe ajo kalon nëpër qytet duke vajtuar ashtu ndër rrethe, e fshehur në një mjegull, duke u sjellur halle vdekatarëve, që e zbuajn edhe qenë gjyqtarë t'padrejtë. Kurse ata që zakonisht u japin t'drejtën e duhur qytetarëve t'vet

edhe të huajve edhe që kurrë
nuk i braktisin rrugët e drejtësisë,
ata gëzojnë në saje të qytetit
një gjallëri, njerëzia lulëzojnë
nëpër krahinë, e paqa, plot me foshnje,
buzëqesh, dhe Zeusi kurrë nuk merr vendim
të sjellë përkundër tyre t'zezën luftë.
Në mes të t'drejtëve kurrë s'gjen uri
apo furi mëkati, por gjithnjë
mes festash të gëzuara zhvillohen
punët e arave, toka për ta
jep fryte me bollëk, atje ndër male
lisi nga maja e vet prodhon, pra, lëndët,
nga trungu bletët; delet leshatake
rëndë janë ngarkuar plot me shufra leshi,
gratë lindin djem, që u ngjasin baballarëve;
edhe gjithnjë njëmijë të mira kanë,
dhe s'detyrohen kurrë t'hipin n'anije:
toka, që prodhon tepër, ata i ushqen.
Po atij, që vë n'zbatim dhunën e keqe,
punët e prapta, Zeusi i biri i Kronit,
i jep ndëshkimin edhe mbarë qyteti
e paguan shtrenjtë të zezën e një t'vetmi,
që ndjek rrugën e keqe, që përlyhet
me vepra t'prapta. Atyre vetë Kronidi
u sjell nga qielli hidhërime t'rënda:
urinë edhe murtajën. Njerëzia
bien vdekur dhe as gratë nuk lindin më
fëmijë, shemben shtëpitë, se ashtu do
Zeusi, zot i Olimpiti; ndonjëherë
ai shkatërron dhe një ushtri të madhe,
shemb një forcomë ose dhe midis detit
Kronidi i shpartallon edhe anijet.

30 MIJË RUAJTËSIT E DREJTËSISË

Po edhe ju, o sovranë, ta keni mendjen
te drejtësia e Zeusit, për arsye
se, duke qenë pranë njerëzve, perënditë
dallojnë ata, që e shtrembërojnë të drejtën
dhe duke i sjellë andralla njëri-tjetrit
s'mendojnë aspak për syrin e hyjnive.
Sepse mbi tokën e begatshme ndodhen
tri herë dhjetmijë rojtarë të pavdekshëm,
që Zeusi i ka caktuar për mortarët
dhe që gjithnjë mbikqyrin drejtësinë
dhe veprat e padrejta dhe, të veshur
me mjegull, bredhin në çdo anë të botës.
Pa është dhe Drejtësia, virgjëresha
që e lindi Zeusi e meriton t'nderohet,
atë e nderojnë edhe hyjnitë, sunduesit
e Olimpit. Kur dikush i shkakton dëm
ose një dhunë mashtruese, menjëherë
ajo te Zeus Kronidi shkon dhe me zë t'largë
tregon lakmitë e njerëzve t'padrejtë
dhe populli paguan marrëzitë e zeza
të mbretërve, të cilët, mendjezez

dredhojnë nga drejtësia edhe japin
dënime të padrejta. Kini mendjen,
o ju sovranë t'pangopur, drejtësinë
ta mbani n'rrugë të drejtë, hiqni nga mendja
dhunën e prapë; njeriu që u sjell të tjerëve
andralla, ia ka sjellur vetes s'vet:
këshilla e keqe e zezë është më parë
mu për atë që e jep, se syri i Zeusit
çdo gjë shikon, të gjitha i përfshin.
Edhe këtu, po deshi, tani sheh;
dhe s'i shpëton pa parë çfarë drejtësie
ka brenda ledheve t'qytetit tonë.
Oh, kurrë mos paça rast të jem gjyqtar
mes njerëzve, as djalit mos m'i ndodhtë
një punë e tillë! Sepse është një e zezë
të jesh gjyqtar, në qoftë se prej davave
fiton një batakçi. Po s'dua t'besoj
që Zeusi ta lejojë një punë të tillë.

E KEQJA DHE VIRTYTI

O Pers, o budalla, dua të flas
bash për të mirën tënde. Prapësinë
shumë lehtë mund ta fitosh, krejt mund ta rrokësh:
se rruga është e sheshtë edhe e shkurtër.
Mirëpo hyjnitë përkundrazi vendosën
që jo pa djersë t'arrihej te virtyti,
rruga për t'iu afruar është e gjatë,
n'fillim është e rrëpirtë edhe e ashpër,
por, kur arrin atje në majë të majës,
bëhet e lehtë, sado që ish e vështirë.

TË MENÇUR E BUDALLENJ

Nuk ka njeri më t'mirë se sa ai
që di të arsyetojë me kokë të vet
edhe i parashikon të gjitha punët
që mund të dalin mirë e faqe bardhë.

I mirë është edhe ai që i vë veshin
atij që di të japë këshilla t'mira.
Por kush nuk di t'mendojë me kokë të vet,
as di t'vërë veshin kur ai tjetri flet
edhe t'i japë atij rëndësinë e duhur,
aherë ai nuk vlen asnjë para.

PUNA DHE PËRTACIA

Ti, o Pers, o fis hyjnor, duke mbajtë mend
gjithnjë këshillën time, pra, puno
që t'mos t'mundojë uria edhe gjithmonë
të t'dashurojë Demetra, e nderuara,
kurorëkallirja, e gjithmonë të ta reshë
me grur'hambarin. Për shkak se uria
gjithmonë zë vend te njerëzit përtacë.
Si njerëzit si zotat janë armiq
t'atij që është dembel dhe ndjek zakonin
e mashkullit të bletës, që jeton
pa mund, pa bërë asgjë, veç duke prishur
mundimin që bëjnë bletët. Pra kënaqu
duke e kryer me kohë punën e duhur
kështu që, kur nevoja t'paraqitet,
ta kesh hambarin tënd plot me të mira.
Puna i bën njerëzit t'pasur me kope
edhe me t'mira e n'rast se do t'punosh,
oh, shumë më tepër ty kanë për të t'dashur
Hyjnitë edhe mortarët që, të gjithë,
i urrejnë sa s'ka ata që janë përtacë.
Jo: asnjë punë s'është turp; të mos punosh

është turp, prandaj puno, dhe, cilido
që t'jetë demoni¹⁾ yt, gjëja më e mirë
është puna, n'rast se ti duke e larguar
atë shpirtin tënd t'pamend nga gjëja e huaj,
do t'kesh dëshirë t'punosh edhe kështu
ta fitosh bukën si po t'këshilloj.

1) Të vjetrit mendonin se çdo njeri kishte një gjeni
vetiak frymëzues për mirë ose për keq.

MOS VIDH

Mallin e huaj ti kurrë s'duhet ta vjedhësh:
ia vlen më mirë çfarë t'japin perënditë.
N'rast se ndokush fiton shumë pasuri,
në daç me dhunë, n'daç me fjal'dinake,
siç ndodh shpeshherë, në rast se e prish pra,
mëndjen
etj'e fitimit, n'rast se paturpsia
e mban t'nënshtruar turpin, e po aherë
hyjnitë shumë lehtë atë njeri e dërrmojnë;
shemben shtëpitë e një njeriu të tillë,
dhe ajo kamje fare pak mund t'zgjasë.

BUJQËSIA

Pra kur Plejadat, bijat e Atlasit,
ngrihen në qiell, aherë është koha e korrjes;
kur perëndojnë është koha e lërimit.
Ato për dyzet ditë dhe dyzet net
qëndrojnë të fshehura, pastaj sërish,
duke u vërtitur viti n'rrotullim,
kur mprehen drepërit, aherë rikthehen
dhe vezullojnë në qiell. Pra kjo është norma
e arave për t'gjithë ata që rrojnë
pranë detit; për ata që e kanë banesën
larg detit, ndër lugina mjaft të thella,
ndër toka t'majme: ata duhet të mbjellin
të zhveshur dhe të zhveshur t'shtyjnë parmendën,
të kenë kujdes për korrje n'qoftë se duan
që punët e Demetrës t'kryhen t'gjitha
me kohë. Sepse çdo punë duhet të kryhet
me kohë, në qoftë se s'do të shkosh si lypës
në derë të huaj, sa herë që t'kesh nevojë,
duke kërkuar, por pa nxjerr' asgjë
sikurse erdhe dhe tani tek unë.
Por ty asgjë nuk dua të t'dhuroj,

asgjë nuk dua të t'jap hua. Puno,
 o Pers, o budalla i budallenjve,
 merru me punë, që vetë hyjnitë ia vunë
 gjithë njerëzve për detyrë për në mos daç,
 me zemër të brengosur bashkë me gruan
 e me fëmijë, t'u lypësh bukë fqinjve,
 të cilët nuk kujdesen hiç për ty.
 Ndoshta nja dy-tri herë diçka do t'japin,
 por, po i mërzite, asgjë s'do t'japin më,
 llafet e tua do të t'i marrë era
 dhe gjuha e gjatë asgjë nuk do t'të vlejë.
 Prandaj, po t'them, paguaj borxhet e tua,
 merr masat që t'mos mbetesh krejt pa ngrënë.
 Para së gjithash merr, pra, një shtëpi
 një dem, një grua, nuk po them bashkëshorte,
 por një shërbyese t'blerë, që të kujdeset
 për demat, dhe pastaj aty n'shtëpi
 veri në rregull veglat që të gjitha,
 t'mos jetë nevoja t'ua kërkosh të tjerëve
 që ndoshta nuk t'i japin, dhe ti mbetesh
 pa gjë dhe koha e duhur kalon kot
 dhe e pëson puna. Punët mos i lë
 për nesër e pasnesër: se i papuni,
 njeriu që vazhdimisht i shtyn pra punët,
 s'e mbush hambarin kurrë: puna e pareshtur
 jep fryt, njeriu që vazhdimisht shtyn punën,
 gjithmonë do t'jetë në luftë me vështirësitë.
 Pastaj, porsa tërbimi përvëlues
 i diellit nuk e jep më atë vapë
 që t'lodh, t'këput, dhe Zeusi i pushtetshëm
 na i resh shirat e vjeshtës, atëherë
 vijnë e ndryshojnë gjymtyrët e njeriut,
 shumë më të lehta bëhen, sepse dita

atë yllin «Sirius» pak e sjell mbi kokat
e njerëzve, të lindur për të vdekur,
dhe nata nëpër qiell baret më tepër.
Aherë nuk prishen hiç lëndët e pyllit
n'qoftë se i cungon dhe hekuri, se aherë
i hedhin gjethet n'tokë, nuk qisin bula.
Mbah mend se kjo është koha e përshtatshme
për të prerë pyjet: ndreq, pra, një havan
të gjerë tri këmbë dhe shtypësin tre kutë
dhe boshti të t'jetë shtatë: gjatësia e duhur;
po t'jetë tetëkëmbësh, aherë mund të presësh
si shtesë një majth, edhe një rreth të madh
nja tri pëllëmbë për karron, që do t'jetë
bash dhjetë pëllëmbë dhe drurin ta ketë t'thatë,
të këthyer mirë; n'shtëpi sille timonin,
kudo që do ta gjesh, kur ta kërkosh,
në mal, në fushë: edhe të jetë prej ilnje,
se ilnja është druri më i përshtatur
për një lërim me dema bash aherë
kur farkëtari i Atenës ta ketë ngulur
aty te cungu dhe ta ketë forcuar
me kunj pra aty afër. Ti, parmenda
dy duhet t'kesh edhe t'i bësh n'shtëpi:
njërën një cope, tjetrën thuke¹⁾ mirë.
Është punë e madhe, se, po t'thyhet njëra,
ti demat do t'i mbrehsh tek ajo tjetra.
Timoni t'jetë dafine ose vidhi,
që s'preket aq nga mola, kurse cungu
të jetë prej lisi dhe timoni ilnje.
Dy demat të jenë meshkuj, nëntëvjeçarë,

1) mbërtheje

se aherë fuqinë e kanë fare të freskët,
 në lulen e rinisë, sepse aherë
 punojnë më mirë: dhe kurrë s'do të t'ndodhë
 që të zihen bashkë aty në mes të brazdës,
 ta thyjnë parmendën dhe kështu të mbetet
 pa u kryer puna. Ata duhet t'i ngasë
 nj'argat që pak a shumë t'jetë dyzet vjeç,
 me vete t'ketë franxhollën në trajtë kryqi
 të ndarë n'tetë pjesë, t'shikojë punën e vet,
 n'brazdën e vet të çajë përpara drejt,
 të mos habitet hiç duke shikuar
 djemtë e tjerë, por t'rrijë me mendt' te puna;
 asnjë nga t'rinjtë s'e hedh farën më mirë
 dhe si pasojë pastaj na mbjell dy herë
 çuni hutohet, sytë i ka te çunat.
 Ki mendjen kur dëgjon se lart nga retë
 zbret zëri i kurrilës, që çdo vit
 kthehet sërish. Ajo ty ta sjell kohën
 për të lëruar edhe të kujton
 se shiu edhe dimri kanë arritur:
 trishtim për gjithë ata që nuk kanë qe.
 Aherë duhet të kesh aty n'shtëpi
 dy dema brinatakë, se e lehtë do t'jetë
 të thuash: «Nem hua parmendë e dema»,
 por dhe më lehtë të thuhet «Qetë janë arave».
 Një mendjelehtë hidhet: «Zor i madh
 të bësh parmendë!» Oh se ç'budalla,
 ai as nuk di sa pjesë duhen për të;
 njëqind; dhe puna e parë t'i kesh n'shtëpi.
 Tani, pra, porsa njerëzit të shohin
 shenjën për të lëruar, atëherë
 dilni ndër ara t'gjithë, dhe ti me sklevërit

n'të njomë dhe në të thatë edhe lëroni:
është koha për t'lëruar qysh n'të gdhirë
dhe sa më shpejt që t'kryhet e gjithë puna.
N'pranverë thyej tokën, se pastaj në verë
plisat nuk do t'gënjejnë. Hidh, pra, ndër brazda
ende të buta farën: toka djerr
e zbon syrin e keq dhe i qetëson
trumhasjet e fëmijëve. Lute Zeusin
toksor edhe Demetrën e kulluar
që, kur kokrrat e grurit t'piqen mirë,
të jenë t'shëndosha, luti pra kur s'pari
t'fillosh lërimin dhe ta rrokësh mirë
atë këmbëzën e parmendës te doreza
dhe me hosten t'ua ngasësh shpinën qeve
ndërkohë që rripat ta tendosin kunjën.
Pas teje t'vijë një çun i gjatë ja kaq
me një mëzdrak dhe hiç të mos i lërë
shpendët rehat duke mbuluar farën.
Se për mortarët rregulli është gjëja
më e mira e t'gjithave dhe çrregullimi
më e keqja e t'gjithave. Tani, në rast
se zoti i Olimpët do t'u japë kallinjve
përfundim t'mirë, aherë ata der n'tokë
do të përkulen ngase janë të bollshëm.
Do t'kesh, pra, mundësi t'heqësh prej enëve
krejt merimangat, gjithashtu shpresoj
t'kesh mundësi që ta gëzosh të mirën
që zotëron, pa pasë nevojë për t'tjerë.
Kështu do t'shkosh dërsa t'arrijë e bardha
pranverë: të tjerë do t'kenë nevojë për ty.
Përkundrazi po deshe t'lërosh tokën
në pikë të dimrit, ndenjtur do të korrësh,

në grusht do të shtërngosh ti pak kallinj,
 edhe ashtu si t'vijne ke për t'i lidhur
 mes pluhurit të madh, dhe s'do të mbetesh
 krejt i kënaqur, edhe për t'i mbartur
 do të mjaftojë ty vetëm një kanistër,
 fare pak njerëz do ta kenë zili.
 Dhe po t'lëroje vonë, ti prapë do t'mundje
 ta gjeje një rrugëdalje. Aherë kur qokthi
 këndon atje mes gjetheve të lisit
 edhe mbi tokë t'pafund ua kënaq
 shpirtin gjithë njerëzve, lutu t'bjerë shi
 për tri ditë rresht dhe aspak të mos ndërpritet
 dersa t'arrijë t'mbulojë thundrën e kaut
 dhe as më shumë dhe as më pak, aherë
 si ai që lëroi herët ashtu ai
 që lëron vonë do t'shkojnë krejt barabar.
 Mirëpo ki mendjen, mos harro kur t'vijë
 pranvera e bardhë dhe kur t'vijë shiu i duhur.
 Zgjatet shumë dimri aty përballë punishteve
 të farkëtarëve dhe ndër vende llafesh,
 se ngrica t'mban larg arash, mirëpo prapë
 kush s'është përtac mund t'bëjë shumë punë
 n'shtëpi,
 kështu që as mjerimi dhe as ngrica
 t'mos kenë hiç mundësi që ta mbërthejnë
 brenda shtëpisë dhe t'mos ketë nevojë
 ta ngrohë me atë dorë të thatë këmbën e enjtur.
 Ai i papunë që rron me shpresa t'kota,
 që është shumë nevojtar, ai torturohet
 me tërë atë trishtim që ka në zemër.
 Përtaci, që nuk ka me se të rrojë
 dhe e kalon kohën ku veç bëhen llafe,

gjithmonë do t'rrijë në pritje t'ndonjë t'zezë.
A kaloi gjysma e verës? Thuaj shërbyesve:
«S'ka gjithmonë verë, prandaj mbushni
hambarin».

Ja muaji i Leneut,¹⁾ ditë të këqija
që i rrjepin qetë. Ki mendjen, shmange brymën,
që mu aherë bie dendur përmbi dhe
për sherr kur fryn veriu, që për t'gjatë
Trakisë së pasur plot me pela ngrihet
mbi detin e pamasë edhe tërbohët.
Buçasin tokat, ashtu edhe pyjet,
shkul e përplas era përdhe shumë lisa
të lartë e plot gjethnajë dhe bredha t'bëshëm
duke u plandosur nëpër skuta malesh.
Aherë pylli i pafund është fund e krye
një ulurimë, rrëqethen egërsirat,
shtërngojnë bishtin ndër shalë, e kanë lëkurën
me qime t'errësuar, mirëpo prapë,
megjithëse t'kreshtë e kanë ata gjithë ijën,
ngrica e Veriut atyre u hyn në palcë.
Futet n'lëkurë të qeve, që s'mjafton
për mbrojtje, e dhive u fryn aty përmes
qimeve të dendura, kurse më kot
bën çmos Veriu të depërtojë me forcë
n'bashkën e deleve: është shumë e dendur.
Plakun e bën të struket, mirëpo vajzën
e njomë s'mund ta cenojë; aherë ajo
rri në shtëpi aty pranë nënës s'dashur,
se nuk i njeh endiret²⁾ e Afërditës,

1) Ndërmjet janarit e shkurtit

2) Kënaqësitë

që n'ar stoliset. Lärë mir' e bukur,
 trupin e shkrihtë të lyer krejt me vaj,
 brenda shtëpisë, aty ku është më e fshehur,
 e kalon natën gjatë periudhës s'dimrit,
 kur i paashti¹⁾ asaj këmbën ia bren
 n'kohën që n'strofkë të vet mbetet pa zjarr
 n'tzezën banesë, se dielli s'i tregon
 një vend kullote ku ai t'drejtohet,
 por mbi qytetet edhe përmbi turmat
 e njerëzve zezakë shkon e vërtitet
 dhe popujve t'Helenës pa u shfaqet.
 Sa ka dhe pylli bisha brinatake
 ose pa brirë, me t'mjerën krishtë të dhëmbëve,
 ikin aherë nëpër gremina t'egra
 se t'gjitha kanë një hall: ku t'mund të gjejnë,
 duke kërkuar strehë, home të thella
 shpella të zgavërta. Dhe, ashtu si pleqtë
 përmbi bastun t'mbështetur, ulin veshët
 aty në shpinë edhe turinjtë përdhe:
 si pleqtë, pra i largohen borës s'bardhë.
 Aherë, që ti të ruhesh mirë nga t'ftohtit,
 vish, si po t'them, pra, një këmishë të gjatë,
 që të t'mbajë ngrohtë, edhe një loshnik
 të butë, ku t'ketë pak majë dhe shumë ind;
 vishe këtë, t'mos bëhet ty lëkura
 mornica, mos të t'ngrihet qimja s'ftohti,
 pastaj në t'dyja këmbët shtrëngo mirë
 mbathë prej një kau të therur, rregulluar
 më s'miri, brenda vërë një astar prej leshi.
 Pastaj të marrësh ca lëkura kecash,

1) nuk kuptohet mirë se për çfarë e ka fjalën autori

keca të parë, dhe qepi me pejzë kau,
sa t'vijë të ftohtit, që ta presin shiun
aty në shtat, dhe n'kokë vërë një kësulë,
që t'bjerë tamam dhe të mos t'lagen veshët,
se është i ngrirë agimi n'ato ditë
që fryn veriu dhe nga mëngjesi bie
prej qiellit plot me yje drejt në tokë
mbi arat e fatbardhëve një farë flladi,
që e pjek grurin dhe mbasi e merr ujin
drejt prej lumenjve, që vrapojnë n'amshim,
edhe larg tokës ngrihet atje lart
me gjithë furinë e erës, afër mbrëmjes
herë kthehet n'shi dhe herë zhduket me erë
në qoftë se veriu trakas përsëtepri
i vërtit retë krejt rrotull si mulli.
Prandaj kryeje shpejt punën dhe pastaj
kthehu në shtëpi, përpara se prej qiellit
t'pllakosë errësira me të lagshtëm mjegullë,
përpara se të t'lagë lëkurën tënde,
përpara se t'i ndragë të gjitha rrobotet.
Dhe ki kujdes, se ky nga të gjithë muajt
është më i rëndi. Aherë duhet për qe
gjysma e ushqimit, për njeriun më shumë:
netët e gjata atyre u kursejnë punën.
Duhet kujdes që gjatë të gjithë vitit
të matet mirë raporti ditë-natë
derisa toka, nëna e t'gjitha sendeve,
të na i prodhojë sërish frytet e veta.
Kur Zeusi t'i ketë kryer t'gjashtëdhjetë ditët
e ngricës, dhe t'kalojë, pra, pika e Dimrit,
aherë ylli i Arkturit i braktis
hyjnoret ujra t'rrjedhshme t'Oqeanit,

dhe ngrihet plot shkëlqim për herë t'parë
në perëndim të ditës. Dhe pastaj
e bija e Pandionit, dallëndyshja,
duket n'qiellin e ndritshëm, sepse kthehet
stina e re; dil ti më parë, krasiti
hardhitë, se koha është shumë e përshtatur.
Kur shtëpibartësi¹⁾ shkon prej dheut te bimët,
se ikën nga Plejadat, atëherë
s'ka më stinë vreshtash, por ka ardhur çasti
të mprehen drepërit, të shkunden gjumit
shërbyesit; t'lihen shtëpitë plot hije
dhe gjumi aty n'agim, sepse është koha
për korrje, sepse dielli t'than lëkurën.
Aherë duhet shpejtuar, duhet t'sillen
t'korrat n'shtëpi, sa t'ngrihesh mu n'agim,
po deshe t'mos mungojë ty kurrë jetesa.
Se agimi bën një t'tretën e gjithë punës,
agimi, pra, hap shtegun, po, agimi
i shpejton punët dhe, sikurse duket,
Agimi shtyn shumë njerëz të dalin rrugës,
shtyn sa e sa qafa qesh aty nën zgjedhë.

Kur çel pastaj e madergonës lulja
edhe q'andej prej majës së një peme
gjinkalla e harmonishme na shpërndan
prej krahëve që dridhen pa pushim
zërin e mprehtë, aherë është stina e vapës.
Atherë brenda një shkëmbi plot me hije
shko e gjej strehim edhe t'kesh verë bibline²⁾

1) kërmilli

2) prej vreshtave në malet bibline afër Trakisë.

dhe një kulaç, mish dhie, jo të ngrohta,
dhe mish mëshqerre të kullotur n'pyje,
që t'mos këtë pjellë, ashtu edhe mish keci,
por pjellë e parë, dhe pi aty përsipër
verë të kulluar, ulur aty n'hije
dhe i ngopur mirë me gjellë, e me fytyrë
kthyer andej nga fryn Zefiri i freskët,
te një burim i amshuar e i kulluar,
që t'gurgullojë nga mali, tre çerekët
mbushi me ujë dhe një çerek me verë.
Duhet t'u thuash shërbyesve që ta rrahin
në lëmin-shesh në ndonjë vend të thatë
grurin e shenjtë të hyjnesh'Demetrës
sapo të dalë lart Orion'i egër.
Pra me kujdes ta mbledhin në shinikë
edhe ta masin. Kur t'kenë mbledhur aq
sa të mjaftojë për çdo nevojë t'shtëpisë,
merr një shërbyes, që t'jetë veç pa familje
dhe një shërbyese që t'jetë pa fëmijë,
se, po të kenë fëmijë, janë të mërztishëm;
dhe mbaj një qen dhëmbprehtë dhe kurrsesi
t'mos i kursehet gjella, se përndryshe
ai gjumditori¹⁾ ty çdo gjë të vjedh.
Pastaj mblidh kashtën, ashtu edhe bykun,
që të t'shërbejë sa t'zgjatet i gjithë viti,
për qe edhe për mushka; edhe në fund
lëri shërbyest t'pushojnë dhe zgjidhi demat.
Kur Siri dhe Orioni t'kenë arritur
në majë t'kupës qiellit, kur Aurora
gishttrëndafilja t'shohë yllin e Arkturit,

1) vjedhësi

vreshtat, të gjitha, Pers, duhet t'i vjelësh,
t'mbledhësh bistakët. Për dhjetë ditë me radhë
dhe për dhjetë net duhet t'i qesësh n'diell
dhe n'hije vetëm pesë edhe pastaj
n'të gjashtë ditë këtë dhuratë të Bahtit,
harenë e zemrave, zbraze në tirë.
Dhe kur pastaj Plejadat dhe Hiadat
edhe Orioni i fortë t'zbresin në det,
ki parasysh se bash ajo është stina
e të lëruarit, kështu ndër ara
gjithë viti sistemohet më së miri. x

KALINI

KUSHTRIM

E deri kur do rrini me duar n'ijë?
Kur do tregohi burra, o djelmosha?
Pse jeni mpirë? Si s'ju vjen turp prej fqinjve?
Zien lufta anembanë e ju kujtoni
me mendjen tuaj se keni rënë në paqë.
Secili, qoftë edhe me shpirt ndër dhëmbë,
le të luftojë gjer te shigjet' e fundit,
se për një burrë është nder edhe lavdi
kur për atdhe, për grua dhe fëmijë
lufton kundër armikut, Vdekja vjen
kur ta ken'thën'Fatitë. Ndaj secili
me heshtë ngritur le të shkoj'përpara,
me shqyt ta mbrojë zemrën trimëreshë
sapo të ndizet flak'e zjarr beteja.
S'ka burrë që t'u shpëtojë thonjve të mortjes,
qoftë edhe fis stërgjyshësh të pavdekshëm.
Ka ndodhur shpesh që kush i ka shpëtuar
përleshjes dhe poterës së shigjetave,
mu në shtëpinë e vet ka gjetur vdekjen.
Mirëpo këtë njeri askush s'e do,

askush s'e dëshëron, kurse, përkundrazi,
për një dëshmor vajton i madh e i vogël,
sepse u dhimbset fort trimi me fletë;
po mbeti gjallë e mbajnë si gjysmhyjni,
sepse u rri ndër sy si pìrg i lartë,
sepse fill vetëm vlen sa një mijë vetë.

TIRTEU

VDEKJA ME NDER, KAPAK FLORIRI

Sa hie i ka një burri të nderuar
të bjerë dëshmor aty në radhë të para,
ndërsa lufton për tokën e të parëve.
Nuk ka turp më të madh për një njeri
se kur braktis atdhe e tokë pjellore
e bashkë me babë e nënë e grua e bij
endet andej-këtej duke shtrirë dorën,
krejt i dërrmuar skamje dhe mjerimi.
Sepse ndër ato vise, ku do shkojë,
tjetër ai nuk gjen veçse urrejtje;
poshtron fisin e vet edhe shëmton
për faqe t'zezë shtatin e vet plot nur,
e ndjek kudo poshtrimi edhe vuajtja.
Dersa një burrë, i cili endet rrugësh,
nuk paska nder as vetë as fis'i tij,
t'luftojmë, pra, trimërisht për këto troje,
të vdesim për fëmijë, të mos kursehemi.
Zemër, pra, djem, luftoni sa më t'ngjeshur
bri njëri-tjetrit; jo, mos jepni shembull
frike edhe tërheqje faqezezë
si shkëmb ta bëni zemrën n'krahuar;

të mos ju dhimbset jeta ball'armikut.
Mos i braktisni atje në shesh të nderit
ata më pleqtë që mezi rrinë në këmbë.
Nuk ka turp më të madh se sa të shohësh
shtrirë aty në ball'para të rinjve,
një burrë flokëverd'h'e mjekërthinjur
që jep shpirtin e fortë aty në pluhur
dhe mban me duar organet zhyer n'gjak
(një turp i madh ta shohësh ti me sy)
ashtu krejt zhveshur; kurse një djaloshi
çdo gjë i ka hije dersa ka n'dorë
lulen e bukur të s'ëmbëlës rini.
Burrat atë të gjithë e miratojnë,
vashat e duan dersa është i gjallë;
edhe aherë kur bie dëshmor ndër t'parët,
ai përherë i hijshëm do të qëndrojë.

KËNGË MARSHIMI

O burrani, ju djema baballarësh
t'qytetit t'Spartës, plot e përplot me trima,
jepni mburojës para me të majtën,
jepni dhe merrni trimërisht me heshtën,
jo, t'mos e vrisni mendjen hiç për jetën,
sepse kështu s'e ka zakon, jo, Sparta!

FOKILIDI

GJYKIME

- I. Po edhe kjo është bash e Fokilidit.
Ç'rëndësi ka se janë prej fisi t'largë
ata të cilët s'kanë kurrfarë njerëzie
ndër fjalë edhe mendje?
- II. Po edhe kjo është bash e Fokilidit.
Pra një qytet i qeverisur n'rregull
përmbi një shkëmb, ndonse qytet i vogël,
është shumë më i fortë se Ninivja¹⁾ e çmendur.
- III. Po deshe pasuri, kije n'kujdes
arën e majme, për arsye se thonë
që ara është vetë briri i Amaltesë.²⁾

1) Kryeqytet i Asirisë

2) Amaltea, dhia që, sipas mitologjisë mundi Zeusin në malin Ida, simbol pjellorie.

SOLONI

SALAMINA

Ju sjell një lajm nga Salamina e dashur;
s'do t'flas, por do t'ia them bukur një kënge:

* * *

Më mir' të kisha qenë një folegandras
e sikinitas, ta këmbeja atdhenë,
se sa të jem athinas, pse në çast
bota do t'thonë: Ja një njeri nga Atika,
nga ata që na e braktisën Salaminën!

* * *

Të shkojmë në Salaminë e të luftojmë
Ta lajmë turpin e madh që na mbuloi!

NJË KËSHILLË ATHINASVE

Jo, kurrë qyteti ynë s'ka për t'u shuar nga fat'i Zeusit ose për vullnet të zotave t'pavdekshëm: një hyjneshë shpirtmadhe, bij' e atit të fuqishëm, Palladë Atena i mban dorën mbi kokë. Janë vetë po qytetarët, janë ata që marrëzisht po duan ta fikin fare t'madhin qytet, sepse synojnë te kamja, krerët e tyre nuk kanë shpirt të pastër. Por shpejt do ta paguajnë mendjen e madhe, mbasi s'po dinë ta mbajnë nën fre mujshinë¹⁾ as t'i gëzojnë në qetësi të mirat e gostës, veçse duan t'pasurohen padrejtësisht e nuk kursejnë asgjë, as gjërat shtetërore, as të shenjta, por vjedhin si hajdutë, dikush andej, dikush këtej e nuk u binden fare parimeve të shenjta t'drejtësisë, që n'heshtje vren të tashmen, të kaluarën;

1) Fuqinë, pushtetin

edhe patjetër do të vijë një ditë
 që të kërkojë hesap. Kjo plagë e rëndë
 i është hapur krejt Athinës dhe ka sjellë
 të zezën robëri, e cila ngjall
 trazirat qytetare si dhe luftën
 që ishte n'gjumë, dhe kushedi sa vetëve
 ua dërrmon të ëmbëlën rini.

Sa shpejt po fiket ky qytet i dashur
 për sherr të faqezezëve atje në mbledhje,
 të cilat u pëlqejnë shumë ngatërrestarëve.
 Këto të zeza gjarpërojnë në popull
 dhe *shumë të skamur* ikin n'dhe të huaj,
 të shitur dhe për turp të lidhur prangash.
 Kështu rreziku i zi shkon edhe i futet
 kujtdo n'konak e s'vlejnë dyert e shtëpisë
 për t'ia prerë hovin, sepse kapërcen
 përtej avllis' së lartë e menjëherë
 vjen e të gjen, edhe sikur të futesh
 në skutën më të fshehtë t'dhomës së gjumit.
 Kjo zemër m'urdhëron që t'u drejtohem
 me këto fjalë qytetarëve athinas:

— Sundimi i keq s'i sjell tjetër qytetit ✕
 veçse të zeza, t'zeza pa mbarim;
 ndërsa sundimi i mirë sjell vetëm rregull
 e harmoni t'përgjithshme dhe t'këqijtë
 i hedh në pranga, zbut dhe egërsimet,
 frenon mendjen e madhe, shuan çdo dhunë,
 mjerimit ia than lulet, drejtësinë
 e çalë e bën të drejtë, kryelartësisë
 i vë një fre dhe grindjet qytetare
 i dërrmon fare, zënieve t'përgjakshme
 ua pret furinë edhe për hir të tij
 urti e rregull njerëzit gëzojnë. y

VETË JU E KENI FAJIN

Në qoftë se u shkatërruat nga marrëzia
fajin ju mos ua veni perëndive,
se vetë ua dhatë atyre gjithë pushtetin,
ju vetë i mbrojtët e për këtë arsye
tashti pësoni t'zezën skllavëri.
Secili jush po ecën sot mbi gjurmat
e dhelprës, por të gjithë të marrë tok
e keni trurin bosh, se ju vështroni
se ç'ju thotë gjuha e njeriut dinak¹⁾
e nuk shikoni se çfarë bën ai vetë.

1) Pizistrati, tirani i Athinës

KSENOFANI

NJË GOSTI DIJETARESH

E pastër shtroja, t'pastra duart e kupat
e një shërbyes i vë secilit n'ballë
kurorza, gërshetuar, dhe një tjetër
u sjell në pjatë pomada plot aromë,
e i mbushur është krateri¹⁾ plot hare.
Po ka dhe tjetër verë, t'ëmbël si mjalti
aty ndër shtëmba e mban erën e lules,
ka boll, mos kini frikë se po mbarohet.
Në mes timiani jep aromë të pastër,
e ka dhe ujë kristal, t'ëmbël, të freskët,
dhe bukë të bardha ka, dhe aty tryeza
është plot me djathë e plot me mjalt' si dylli.
Altari n'mes me lule është mbuluar
e në shtëpi përhapet lehtë muzika
me një kënaqësi që flladit shpirtin.
Tashti pra dijetarët le t'ia thonë
një himni për hyjnitë me fjalë të urta
e kuvendimi t'jetë sa më i dëlirë:
Pas libacionit dhe mbasi të lutesh
që të veprosh gjithmonë me drejtësi
— sepse kjo është detyra kryesore —
s'është turp të pish aq sa të mund të kthehesh

vetë, der n'shtëpi, po qe se s'je dhe aq plak.
Por lavde meriton ai, kushdo qoftë,
që dhe kur pi tregon gjëra fisnike
për shkak se kur është fjala për virtyte
kujtesën e ka t'freskët dhe s'na flet
për luftërat e titanve e të gjigantëve
as për centaurë, përralla aq të vjetra,
dhe nuk na flet për grindjet e mëdha
që s'kanë asfarë dobie.

TEOGNIDI

VULË AUTENTICITETI

O Cirn, unë që po flas për urtësinë e ngulsha këtë vulë¹⁾ ndër këto vjersha, dhe po të vidhen, kurrë s'do t'mbeten fshehur dhe askush nuk do t'i kthejë n'diçka më t'keqe, në qoftë aty e gatshme diç më e mirë. Kështu do t'thotë secili: «Këto vjersha janë t'Teognidit, t'atij nga Megara dhe ai është më i përmenduri mes njerëzve». Por prapë është e pamundur t'u pëlqej t'gjithë qytetarëve, dhe nuk është çudi, o djalë i Polipajdit, sepse as Zeusi nuk u pëlqen të gjithëve as aherë kur bie shi, as kur s'e lë të bjerë.

1) Emrin e Cirnit, i cili si njeri i shquar që ishte nuk mund të përmendej kollaj prej ndonjë tjetri. Kësisoj edhe vargjet e Teognidit do të mbe-teshin të paimitueshëm.

TE ZEZAT E VARFERISE

Njerinë fisnik mbi t'gjitha e fik varfëria
më tepër se flokbardha pleqëri,
edhe më shumë, o Cirn, se sa vetë ethet.
Që t'i shpëtosh varfërisë, ia vlen të hidhesh
aty ku është, o Cirn, deti më i thellë,
ose të flakësh thikë nga maja e shkëmbit.
Se çdo njeri, që vuan nën peshë të skamjes,
gjë s'mund të thotë, asgjë nuk mund të bëjë
për shkak se gjuha e tij është lidhur nyje.

NJË PYETJE ZEUSIT

O Zeus i dashur, m'vjen çudi për ty,
që je zot mbi të gjithë edhe nderohesh,
e ke gjithë atë fuqi edhe gjithkujt
shumë mirë ia njeh si mendjen edhe zemrën;
pushteti yt, o zot, nuk ka kufi.
Atëherë qysh duron urtia jote,
o djalë i Kronit, që njeriu i mbrapësht
të këtë të njëjtin fat që ka dhe i drejti,
si u prirka njësoj zemra drejt urtisë
si dhe drejt prapësisë, siç ndodh me njerëzit,
që janë mësuar me vepra të padrejta?

LARG ATDHEUT

Dhe unë dikur vrapova n'Sicili,
shkova n'Eube, një fushë veshur me vreshta,
shkova në Spartë, qytet i mrekullueshëm
i Eurotës, që është mbushur me kallmishta;
kudo më pritën me fytyrë të qeshur.

Mirëpo ç'e do? Askund s'më këndoi zemra;
nuk paska gjë më t'ëmbël se atdheu!

KLITHMA E KURILLAVE

O Polipajd, unë e dëgjova klithmën
e mprehtë t'atij shpendi, që lajmon
se ka ardhë koha të punohet toka;
ah, se ç'ma vrau të zezën këtë zemër,
se tjetërkush m'i ka ato farë arash
e mushkat s'e tërheqin më për mua
shtagën e plorit, dhe këtë për sherr
t'atij mallkim lundrimi...

MALLKIM

. . . t'përplasur n'mes të valëve, e n'Salmides
e kapshin krejt të zhveshur ata trakas
ballukengritur — pamje shumë e këndshme —
ku do t'pësojë shumë t'zeza duke ngrënë
bukë sklevërish dhe i ngrirë ashtu nga ngrica
në vrull të dallgës humbtë mes leshterikëve
dhe dhëmbët i kërcitshin mu si qenit,
i shtrirë me gojë përdhe, i rraskapitur
pranë bregut të rrëpirtë, bashkë me tallazet.
Pikërisht kështu e pafsha unë atë
që të padrejtë na bëri edhe i shkeli
betimet ai që mik më kish përpara.

PAVDEKËSIA

Të dhashë unë aso flatrash me të cilat
do t'fluturosh mbi detin e pamasë
edhe mbi tokën mbarë pa farë mundimi.
Gjithnjë ke për t'u gjetur nga çdo anë
ndër sofrë e ndër kremtime, e bota mbarë
ty do të t'ketë në gojë, edhe rinia
në mes të melodisë së hollë të fyejve
veç ty do të t'këndojë ëmbël e bukur.
E kur do t'shkosh ndër angrra t'dheut të zi
atje në Hadë, të mbushur plot me lot,
jo as aherë, si t'i kesh mbyllur sytë,
s'do t'mbetesh pa lavdi, ty prapëseprapë
mbarë bota do të t'dojë dhe për amshim
do t'mbetet nami yt, o Cirn; do t'endesh
ndër tokat dhe ndër ishujt e Heladës,
do t'shkosh tej detit të pamasë plot peshk
jo n'shpinë të kuajve:¹⁾ ty do të të mbajnë
dhuratat e shkëlqyeshme që do t'kesh
nga Muzat, kurorëzuar plot me vjollca.
Ndër gjithë ata që do ta kenë për zemër
këngën në të ardhmen, ti njësoj do t'rrosh
gjersa të ketë një tokë edhe një diell.

1) Janë «Kuajt e detit» - valët, tallazet.

ARKILOKU

NJË KËSHILLË ZEMRËS

Moj zemër e përplasur ndër andralla
të pasherim, oh mbahu, qite gjoksin
dhe merr qëndrim të fortë kundër armikut,
ngul këmbë në pritë të tij edhe tregohu
gjithnjë e patundur dhe, kur del fituese,
ti mos u mburr aspak në sy të tjerëve
edhe, kur del e mundur, mos vajto
përmbys n'shtëpi; gëzohu ndër gëzime;
mos mbaj shumë hidhërim ndër hidhërimë,
ta dish, pra, se kështu e ka kjo botë.

DUKJA TË GENJEN

Nuk më pëlqen ai kapidan shtatmadh,
që mburret dhe marshon me goxha hapa
i rrojtur bukur-bukur; më njafton
dhe një voglush, qoftë dhe këmbështrembër,
por t'ketë këmbët çelik, t'jetë guximtar.

PO AFROHET STUHIA

Shiko, ti Glauk, sa fort është turbulluar
plot dallgë ky det i thellë edhe një re
po qëndron pezull n'majat e Gyrejve,
shenjë se afron stuhia; çfarë trishtimi.

LARG PASURISË

S'më duhet gjë gjithë ai flori i Gigit
as malli kurrë s'më mori, as zili
s'ua kam hyjnive, as dua mbretëri të madhe,
jo, sytë e mi s'e kanë këtë pikësynim.

PAS NJË FATKEQËSIE

Ç'hidhërim i fortë na ra, o Perikli!
Asnjë qytetas, as i gjithë qyteti,
zhytur në zi, s'do të dëfrejn'n'gostira.
Se ç'njerëz na gëlltiti ajo dallga
e detit shungullues; sa fort është enjtur
kjo zemër nga hidhërimi. Por hyjnitë
për çdo sëmundje, që nuk ka shërim,
kanë dhënë një bar, o vëlla: ky është durimi.
Kjo mund t'i ndodhë herë njërit e herë tjetrit;
sot na ra neve e pra po derdhim lotë
mbi këtë plagë t'përgjakur, kurse nesër
do t'u takojë të tjerëve; pra, durim;
zia është punë për gra e jo për burra.

LIKAMBIT

Si the, baba Likamb, si the? Ty trurin
kush ta shtrëmbëroi? Dikur
ti mendt' i kishe n'vend; tashti, për nder,
m'u bëre gazi i dheut.

SEMONIDI

GRATË

Kjo tjetra lindi prej një pele s'butë
plot krifa, e u shmangët punëve t'rënda,
as mokër, jo, as sitë nuk prek me dorë,
as mbeturinat nuk i flak shtëpie
as rri te vatra, mbasi t'heqë blozën,
burrin e dashuron veç nga nevoja.
Dy a tri herë në ditë lahet, pastrohet,
lyhet me erëra t'mira edhe i kreh bukur
flokët e derdhur, hijeshuar me lule.
Nuk ka dyshim, të tjerve një e tillë femër
u duket me t'vërtetë një mrekulli;
por mjerë ai që e ka, veç në mos qoftë
një mbret a sundimtar me skeptër n'dorë,
që gjen kënaqësi në punë të tilla.

* * *

Kjo tjetra prej një blete doli n'dritë;
si lum ai që e mori këtë femër,
se vetëm kjo nuk ka nevojë të nëmet;

me të të lulëzon, të zgjatet jeta,
e plaket bashkë me burrë, që e do si shpirtin,
nënë e një race t'bukur dhe t'përmendur.
Ndër t'gjitha gratë spikat si më e nurshmja
edhe i bie një hije perëndeshe;
as i pëlqen të rrijë me gra të tjera,
që rrinë e flasin veç punë dashurie.
Të tilla gra kaq t'urta dhe fisnike,
që s'kanë kund shoqe, i fali Zeusi vetë.

HIPONAKTI

LUTJE

Hermes, Hermes i dashur, djalë i Majës,
o Cilené, betohem, ngriva s'ftohti,
falja pra Hiponaktit një loshnik
dhe një tunikëz e një palë pashmangëza¹⁾
dhe një palë këpucë e, me q'ra fjala,
nja gjashtëdhjetë staterë-florinj ti falja.

* * *

Falja pra një loshnik ti Hiponaktit:
se m'hyri mardha, më kërcasin dhëmbët.

* * *

Po ti asnjë loshnik të trashë s'më fale,
që n'dimër i bën ballë aq fort acarit;
as m'i mbulove këmbët me këpucë,
të paktën t'mos pëlcisnin këta mortha.

1) Pandofla

As Pluti, ai qorr qorri, s'më ka ardhur
n'shtëpi për të më thënë «O Hiponakt,
na, merri tridhjetë pare të argjendta,
e shumë të tjera», ai është një horr!
Ka për të vuajtur zemra ime e shkretë,
po s'më dërgove shpejt ti një hu¹) elb,
ta bëj një qull me miell edhe ta ha
si ilaç n'gjithë këtë hall që më ka gjetur.

1) Masë dridhi.

ALKEU

ARMËT TË GATSHME PËR MBROJTJEN E ATDHEUT

Shkëlqen godina e madhe prej tumbaku;
për Aresin krejt salla ishte zbukuruar
me përkrenare plot me vezullime,
ku bardhë derdhen valë-valë krifat e kalit,
të gjitha një stoli për kryet e burrave.
E rrethas janë radhitur nëpër gozhda
kollçikët vezullues po prej tumbaku
për t'u bërë ballë shigjetave mizore
e grumbull me parzmore liri t'ri
qëndrojnë edhe mburojat krejt kupace.
E aty përbri ka shpata kalqidike
e ka kushdi sa rrypa dhe tunika.
Këto s'duhën harruar, se mbi t'gjitha
një barrë të tillë i vumë ne vetes sonë.

LE TË PIMË SA TË JEMI GJALLË

Pi, Melanip, e dehu bashkë me mua!
Po si kujtove ti? Kur të kalosh
tej Akerontit, që valon me gjire,
kujton se përsëri do ta shikosh
rrezen e pastër t'diellit? Oh, dëgjomë,
shporru asi mendimi, je shumë larg.
Edhe Sizifi, ai mbreti i eolidëve,
mendonte t'u shpëtonte thonjve t'Mortjes
me zgjuarsinë e vet, po prapëseprapë,
megjithëse mjaft dinak, iu desh t'kalonte
së dyti n'të rrëmbyeshmin Akeront,
edhe Kronidi atje nën dhe të zi
i vuri barrë të rëndë, edhe çfarë barre!
Mos e ço mendjen, pra, hiç atje poshtë,
sa jemi t'rinj, se sot më fort se kurrë,
duhet që t'i durojmë të gjitha sprovat,
që Zeusi i ka caktuar pra për ne.
E ndërsa fryn veriu me furi,
ta pimë këtë verë si mjaltë, ilaç hidhërimesh.

NË PISKUN E VAPES

Lagi mushkëritë me verë, sepse dhe dielli,
po e kryen udhën e vet; sa kohë e rëndë!
Çdo gjë digjet për ujë e atje ndër degë
se ç'po kërllin e ëmbëla gjinkallë...
Lulëzon dhe madërgona e gratë po digjen
dhe burrat janë këputur, sepse ai Siri
të përvëlon në kokë edhe ndër gjunj.

KUJDES, O ANIJE. . .

Nga vrulli i erërave sa fort tronditem
se andej-këtej, pra nga të katër anët,
na rrokulliset dallga e ne në mes
stuhi'e madhe na troshit pa masë
e na zvarris me anijen e zezë.
Se tani vala këmbën e direkt
e zuri fare e veli i gjithë u gris,
dhe copa t'gjera mbeten varë përposhtë,
po dhe litarët ja ja, po lirohen.

VDIQ TIRANI

Tani duhet të dehemi, të pimë,
qoftë me pahir, se vdiq e shkoi Mirsili.

GJATË STUHISË

Shpejto! t'i mbyllim plasat, të vrapojmë
në portin e sigurtë; dhe asnjërin
prej nesh të mos e kapë e buta ndrojtje,
sepse rreziku duket fare qartë.
Kujtoni vuajtjet që keni kaluar;
tani secili i denjë le të tregohet
për lavdërim dhe t'mos ua marrim nderin
me zhburrërinë tonë etërve trima
që dergjen poshtë nën dhe.

S A F O

AFERDITES

O fronstolisur Aferditë e amshuar,
tinzarja bijë e atit Zeus, të lutem,
me brenga e vuajtje, o hyjneshë e madhe,
mos ma lodh zemrën
por këtu eja, si dhe herë të tjera
kur zërin tim, duke e ndjerë së largu,
dëgjoje e strehën atërore e lije;
qerren prej ari
veje n'zgjedhë e vije, e harabelë të hijshëm,
të shkathtë të sillnin te kjo tokë e murrme,
ndërsa ata rrihnin n'kaltërsinë e qiellit
flatrat e shpejta.
Dhe ja: mbërritën; edhe ti, o e lumtur,
me buzë në gaz e me fytyrë hyjnore
m'pyete çfarë brengje këtu brenda m'brente,
pse të kërkoja,
çfarë mbi të gjitha po lakmontë e çmendura
kjo zemra ime? «Kë do ti që bindja
fill ta drejtojë aty nga zemra jote?
Kush t'bren, o Safo?

Se n'qoftë se t'ikën, prapë te ti do t'kthehet;
n'mos qastë dhurata, ajo vetë do t'japë
n'qoftë se s'të do, ka për të dashë së shpejti,
dhe po nuk deshi».

Tani pra eja dhe të rëndën brengë
largoma, t'lutem, dhe plotsomë dëshirën
që kam në zemër e si shoqe lufte
të jesh me mua!

PASION DASHURIE

Njësoj si hy më duket ai njeri
që t'rri përballë edhe aty pranë teje
t'vështron kur t'ëmbël e shqipton ti fjalën
dhe buzëqesh
plot ëmbëlsi; po mirë po n'krahuar
peshë ma çon zemrën buzëqeshja jote
pse, duke t'parë, mua asnjë fije zëri
s'më vjen te buza;
gjuha më pritet edhe n'ato çaste
se ç'm'gjarpëron një zjarr i hollë ndër deje;
sytë nuk më shohin edhe brenda veshëve
më zien oshëtima;
rrëke shkon djersa edhe fund e krye
m'rrëqethet shtati edhe vij e bëhem
si fije bari dhe për pak më duket
se m'mori mortja.

MBRËMJES

O mbrëmje, gjithçka merr agimi i ndritshëm
ti prapë e kthen; kthen dhinë, e kthen dhe delen;
te prehri i nënës s'vet kthen edhe djaln.

HËNA E PLOTË

Yjet rreth hënës s'bukur menjëherë
seç e mbulojnë fytyrën vezulluese
kur rrumbullak përmbi mbarë tokën
qëndron me atë shkëlqim të plotë të vetin.

LAMTUMIRE

«Më mirë t'isha nën dhe!» Me lot ndër sy
ajo, duke m'braktisur, kështu m'thoshte:
«Ah, ç'hidhërim i madh për ne, o Safo!
Me ç'plagë në zemër po largohem teje».
E unë ia prisja: «Jo! Nisu e kënaqur
dhe më kujto. Ti e di sa fort të desha;
të paktën ti ta mbash në mend përherë,
sepse harron se sa u deshëm bashkë,
sa bukur e kaluam. Sa herë m'solle
kushedi sa e sa kurora manushaqesh,
marajash, trëndafilash e safranesh,
kushedi sa e sa gushore të gërshetuara
për t'njomën gushë me lule t'erëkëndshme.
Ç'm'i lyeje ata flokë, të krehur bukur,
me vaj erëndshëm, pastër si biluri,
që i japin lulet, vaj si për mbretëresha».

KROI

Rrotull një ujë krejt akull
seç murmurit së larti
mu nëpër degë të mollës:
nga shushuritja e fletëve
rrjedh një t'përgjumur i ëmbël.

QIPRIDËS

Eja, o Qipridë, e zbraze
ëmbël n'të artat kupa
nektarin dhe përzieje
me kënaqësitë e tua.

MES SHOQEVE

Tani shoqeve t'mia
këto melodi të këndshme
sa bukur do t'ua këndoju.

NATË E VETMUAR

Ja, perëndoi pra hëna,
ashtu edhe Plejadat
dhe nata vajti në gjysmë,
dhe ora ecën ecën
dhe unë fle fare vetëm.

E BUKURA E LARGËT

Tani ajo mes vashave lidiane
shkëlqen si ndonjëherë kur, sapo dielli
bie n'perëndim, gishttrëndafilja hënë
ua kalon gjithë yjeve dhe drita
shkon duke u përhapë mbi ujrat e kriposur,
ashtu edhe mbi fushat e lulëzuara.
Dhe vesa e bukur shtrihet nga çdo anë
dhe lulëzojnë ashtu dhe trëndafilat,
dhe lulebleta e njomë edhe tërfili

në lulëzim. Dhe, mbasi t'endet mirë
plot me kujtim te malli i s'njomes Ati
n'shpiritin e brishtë, zemra¹⁾ lëndohet rëndë.

1) Zemra e poeteshës

MOLLË E HARRUAR¹⁾

. . . Siç kuqjon molla e ëmbël majë degës,
në majë të majës, vjelsit e harruan.
Jo, s'e harruan, por s'e arritën dot.

1) Fragment poezie, ku ruhet vetëm pjesa e dytë e krahasimit.

ANAKREONTI

FUQIA E DASHURISË

Më pëlqen t'ia them një kënge
për Erosin njomëzak,
kurorëzuar me lloj-lloj lulesh;
perënditë ai i sundon,
ai mortarët i nënshtron.

FYTAFYT ME DASHURINE

Sillna ujë shpejt, ti o djalë,
sillna verë e sill kurora
gjithfarë lulesh të stolisura,
sepse sot unë do të zihem
fytafyt me dashurinë.

MOJ MËZJA PREJ TRAKIE

Moj mëzja prej Trakie, pse shikon
me sy tërthorazi? Mos kujton, vallë,
moj zemërgure, se nuk vlej asgjë
që më largohesh? Pra ta dish se unë
mund ta mbërthej mëgojmën fare mirë
dhe rreth e rrotull caqeve të vrapit
të t'sjell me frerë; ti sot kullot livadhesh,
kërcon edhe lodron se të mungon
kalorsi i aftë që t'mbajë aty nën fre.

Ç'TU BËJ THINJAVE

Vjen e m'hedh një top të purpurt
ai Erosi, flokët ar,
dhe më fton që të mahitem
me një vashë sandalelarme.

Por ajo — dhe ta pret mendja, —
— dërsa është nga Lesbi i bukur
se ç'm'i shan flokët e mi
për arsye se më janë thinjur;
do të tjerë, sido që t'jenë.

GOSTI GAZMORE

Nuk më pëlqen ai tip
që, duke pirë ca verë,
pranë kupës plot përplot,
na flet me lot ndër sy
për grindje edhe për luftra;
mua m'pëlqen ai
që, duke gërshetuar
dhuratat e shkëlqyeshme
të Muzave e t' Afërditës,
të sjell aty në mendje
të ëmblën dituri.

ALKMANI

NATË E QETË

Flenë majat e larta të bjeshkëve,
rrëmore, shkëmbinj dhe humnera
e sa zvarranikë, që ushqehen
atje tej nën tokën e murrme,
e bishat e malit e bletët
ashtu dhe përbindshat e frikshëm
në gropat e detit të bruztë,
e flenë edhe shpezët krahgjata.

SIKUR TË ISHA QERIL¹⁾

Aman, moj vajza, që këndon i aq ëmbël
me atë zërin tuaj, nuk po më mbajnë më gjunjët.
Të isha qeril e shend e verë t'fluturoja
bashkë me pulbardhat për rrëshqit suvalëve:
si fluturak i purpurit pranveror.

KËNGA E THËLLËZAVE

Të tilla fjalë edhe të tillë muzikë
Alkmani i gjeti duke imituar
klithmën e thëllëzave, të shprehur n'fjalë.

1) Mashkulli i pulëbardhës

STESIKORI

KUPA E DIELLIT

E Dielli Hiperionidi në kupën floriri
gjatë oqeanit po zbriste t'arrinte së fundi
ndër skutat e natës së shenjtë mbuluar nga errësira,
pranë nënës e nuses së re edhe foshnjeve t'ëmbra;
e ai tjetri, ai biri i Zeusit, në këmbë po drejtohej
në pyllin plot hije dafinash...

IBIKU

KËNGA E PRANVERËS

Ftonjtë edhe shegët,
që njomen prej ujërash, ku ndodhet
kopshti i paprekur i nimfave;
bulat n'hardhi, që harlisen
nën trishkujt¹⁾ plot hije e raskaj,¹⁾
çelin se erdhi pranvera.
Por dashuria, që as dimër as verë
s'pushon dot për mua,
si ajo Borea trake,
që ndizet krejt vetëtimash,
duke shpërthyer drejt prej Qipridës
me një furi plot me rreshk,
e errët dhe shumë guximtare
prej fëmijnie me forcë
zemrën mua krejt ma pushtoi.

1) Degëza e gjethe hardhie

DASHURI NË PLEQERI

Erosi prapë m'shikon me sy gjithë neps
nën t'kaltërtat qepalla, edhe me lajka
gjithfarësh seç më flak aty në rrjetë
t'Qipridës, ku qëndroj i ngatërruar.
Por kur e shoh se vjen, sa fort tmerrohem:
si kalë i plakur, që e kanë vënë nën zgjedhë
dhe me pahir i shkreti zë dhe niset
me një koçi të shpejtë drejt vendit t'ndeshjes.

SIMONIDI

VAJTIMI I DANAES

Kur era e dallga e madhe
ia nisën ta lëkundnin
brend'arkës dedaliane,
ajo plot tmerr, me mollëza të njomura,
shtrëngoi në gji Perseun edhe i foli:
«Më plasi zemra, bir!
E ty të zuri gjumi,
e zemra jote e njomë
po fle n'anije t'zymtë,
mbërthyer me gozhda tunxhi.
Fytyra jote, krejt e kapërthyer
n'errësirën manushaqe,
lëshon veç vezullime.
S'të shtie, jo, në mendim shtëllunga e madhe
e dallgës që kalon mbi flokë të tu,
as ulërime e erës,
ndërsa me atë faqe t'bukur
aty ndër vela t'purpurt je mbështetur.
Po ta kuptoje ti këtë farë rreziku,
ai veshi yt i njomë
do t'ma dëgjonte fjalën.

f
Të lutem, fli, o bir, të flerë dhe deti
të flerë dhe ankthi i pambarim.

Sikur prej teje

diç të ndryshonte, ati Zeus!

Në fola me guxim,

dhe pa të drejtë, ndjemë! c

DËSHMOREVE TË TERMOPIlave

«Plot me lavdi është fati, e bukur vdekja
e dëshmorëve n'Termopila;
varri altar, kujtimi n'vend të gjëmëve
e dhembja — lavdërim».

Këtë epitaf as ndryshku s'do ta nxijë
as koha, që s'lë gjë pa shkelë me këmbë.
E kjo shenjtore burrash kaq fisnikë
Lavdinë helene zgjodhi fqinje t'vetën.
Këtë e dëshmon Leonida, mbreti i Spartës,
që la si trashëgim atë farë trimërie
dhe nam që nuk njuh mort.

VIRTYTI

Thuhet se atje përmbi shkëmbinj t'thepisur
banon virtyti e se një valle e shenjtë
nimfash të lehta atij i bën kurorë.
E sytë e gjithë mortarëve atë s'e shohin,
përveç atij, të cilit prej së brendi
i shpërthejnë djersë, që shpirtin ia mendojnë
e me burrëri arrin der n'majë të majës.

TË RËNËT NË TERMOPILAT

O ti i huaj, i lajmëro spartanët
se neve dergjemi në këtë vend
duke iu bindur urdhrave të tyre.

BAKILIDI

LAVDI PAQES

E paqja madhështore i jep njerëzimit
veç pasuri e lule poezish,
të cilat tingëlljnë me ëmbëlsi;
ashtu përmbi altarët dedalianë —
për nder të perëndive — bën të ndizen
në flakën e florinj të kofshët e qeve
e t'dhenve lëshatore.

Edhe të rinjtë nuk merren me punë tjetër
por me palestra, fyej edhe gostira.

Edhe nëpër mbërthejcat e mburojave
të veshura në hekur, kanë zënë vend
cergat e merimangave të zeza.

E heshtat majëmprehta ashtu dhe shpatat,
me teha n'të dy anët, i bren ndryshku.

As nuk buçasin më boritë prej tunxhi,
s'na del më gjumi i ëmbël i mëngjesit,
që zemrën tonë aq fort e përtërin.

E rrugët ziejnë hareshëm me gostira
e ndizen himnet n'gojën e të rinjve.

TEZEU

KORI

Mbret i së shenjtës Athinë, ti zotria i
jonve¹⁾ jetëmbël, pse ra gojtumbakja
bori edhe mori një këngë luftarake?
Thua ndonjë burrë armik
n'krye të hordhive u vjen rrotull
vendeve tona? Apo cubat e poshtër
kundër vullnetit t'barinjve vunë para
me përdhunime kopetë e bagëtime?
Fol, se n'pastë kund njeri që për mbrojtje
mban asi djemsh që janë trima mbi trimat,
oh, jo as ty s'të mungojnë
o bir i Pandionit e i Kreuzës.

EGJEU

Tashti sa arriti kasneci nga e gjata
rrugë istmike në këmbë dhe na foli
për mrekullitë e një trimi me fletë:

1) Athinasit

dhe atë Sinin e rreptë,
ndër mortarë më të fortin
djaln' e Kronid Lete dhelëkundësit
e mbyti e ndër pyje t'Kremionit
theri dhe dosën që hante njerëzit,
vrau dhe Skironin mizorin
edhe Cercionit ia shembi palestrën.
T'fortin çekan seç e flaku Prokusti,
sepse në një më trim ai ndeshi.
Tash pra kam frikë se ç'fund merr kjo punë.

KORI

Thotë se kush është ky njeri? E nga erdhi?
E si është veshur? Mos i prin një ushtrie
veshë edhe ngjeshë si luftar? Apo vetëm
si udhëtar endacak
bashkë me shqytarë na vërtitet
dherave t'huaja aq trim e i guximshëm
sa që burrave të dheut
krejt fuqinë ua shembka? Patjetër
një zot po e nxitka t'u japë
gjithë përdhunuesve ndëshkimin. Përndryshe
kush rrezikon gjithnjë e ka t'zorshme
t'i shmanget mynxyrës:
Çdo gjëje, me kohë, sado vonë, i vjen fundi.

EGJEU

Thotë se ai veç dy burra ka pas,
pallë kryefildishe iu mvarka te supet,
n'dorë dy shigjeta t'lëmuara i mbajtka
dhe ndër kaçurrela, si flaka,
t'hijsme tarogzë lakoniane;
rreth kraharorit tunikën të purpurt
edhe të leshtë një loshnik Tesalie,
edhe ndër sytë e tij vetëtika
flaka e kuqe e Lemnit.
Si djalë i ri, që na qenka, i pëlqekan
lojrat e Aresit e lufta e beteja
plot krisma tumbaku,
dhe shkëlqimdashësen Athinë po kërkoka.

PINDARI

PITIKJA E PARË

STROFË Qeste¹⁾ e praruar, zotrim i përbashkët i
Apolit

edhe i krelvjollcave Muza,
hapi i vallëzimit ndjek tingullin tënd,
me të nis kremtimi,
dhe shenjave t'tua këngëtarët
veshin u vënë kur me dridhje
ti thur preludin e himnit të valles.
Ti fort të mprehtën rrufenë e asaj flake
s'amshuar e shuan,
e përmbi skeptrin e Zeusit dremit shqiponja,
e majtas e djathtas,
i varen krejt flatrat e shkathta

ANTISTROFË mbretit të shpendëve, se mu për-
mbi kokën e kërrusur
ia shtrin ti një mjegull të murrme,
dry për qepalla i ëmbël, e ashtu pastaj e zë
gjumi;

t'butin kurriz e përkul
tingullit tënd e molisur.
Dhe Aresti, ai zemërguri,

1) Vegël muzikore me tela që i përngjan lirës

heshtën majmprehtë lëshon e n'gjumë
zemra ç'i zbutet,
se tingujt e tu, që nxjerr Latoidi e Muzat
gjifryra,

paqtojnë dhe shpirtin e zotave.
E P O D Mirëpo ata që Zeusi s'i do për tmerr tur-
fullojnë,

këngën kur ndiejnë të Pierideve
n'tokë e në det të potershëm;
tmerrohet armiku i hyjnive, Tifoni qindko-
kash,
që dergjet n'Tartarin e tmerrshëm. Dikur ai
jetonte

n'shpellën zëmadhe t'Cilicies;
por sot bregoret e detit të Kumës edhe Sici-
lia
ia ndrydhin kraharorin leshtor; ia shtyp ajo
shtylla e qiellit:
Etna me borëra, ushqyese e pareshtur e bo-
rës së ndriçme,

STROFË dhe nga thellësitë e saja shpërthejnë të
kulluara

gulfa t'një zjarri të tmerrshëm.

Ditën këto gulfa përhapin shtëllunga tymna-
jesh të zjarrta
por kur vjen nata, flaka e kuqe gurë vërvit
e me rropamë të fortë i rrokullis në detin e
thellë.

Mu ky përbindsh na i flak këto shkulme
t'llahtarshme t'Hefetit:
një mrekulli, një çudi kur vrehet, e kush e
dëgjon nga të tjerët
që e panë, dhe ai mrekullohet,

ANTISTROFË se si nga majat pyjezeza të Etnës ai
dergjet

lidhur der poshtë në fushore e
shpinën atij e kërleshta dhe e forta ia vret
ajo shtroja.

Oh, qofsha n'hir tënd, o Zeus,
ti që sundon në këtë bjeshkë,
ballë i një toke pjellore.

Edhe qytetit që emrin i mban e krahas i
shtrihet,
namin ia qiti zëmadhi ndërtues, se n'arenën e
Pikit kasneci na e shpalli këtë emër

EPOD n'lajme të fitores s'Hieronit me qerre. Për
njerëzit, që nisin udhën në det, është fati m'i
parë një erë e volitshme
se ky është ugur i një kthimi fatbardhë. Kë-
shtu dhe arsyeja për hir të këtij fati beson
se edhe n'kohën e ardhshme
qyteti i Etnës do korri
nam si për kuaj dhe kurorë, do përmendet
n'gostira me këngë.

Feb, ti o mbret i Likisë dhe i Delit, që e do
aq fort gurrën kastalje n'Parnas, të pëlqeftë
fjala ime, të pëlqeftë ky vend burrash.

STROFË Dhuratë e hyjnive janë punët që kryejn
virtytet e njerëzve:

kush ka urtinë e kush forcën e krahut
e kush gojtarinë. Edhe unë që po i
thur lavdërime një burri të tillë, nuk uroj
të dal si ai që të bronztën
shigjetë e vërtit tej kufijve;
oh, atë do ta flak shumë më larg se rivalët e mi.

Koha si sot e gjithmonë të mbarën i dhëntë,
i dhëntë dhe t'mira
e bëftë të harrojë edhe dhimbjet.

ANTISTROFË Koha i kujtoftë ç'përleshje me shpirt
guximtar përballoi,
nëpër beteja me ndihm'hyjnore
korri të tillë lavdi që askush prej helenëve
s e korri:

kurorë shumë e lartë pasurie.
Sot nëpër gjurmë t'Filoktetit
n'fushën e nderit ai zbriti
dhe mendjemadhin nevoja e shtyu që atë ta
miklonte.

Thonë se dikur atje n'Lemn ca heronj gjys-
mëhyjni po kërkonin

djaln shigjetar të Peantit,

E P O D t'brejtur nga një plagë e pamasë, dhe ky të
Priamit qytetin rrafsh seç e bëri dhe fund
përgjithmonë i dha vuajtjes s'danajve,
megjithëse me shpirt nëpër dhëmbë: se kë-
shtu ish shkruar.

Oh, hyu e pastë këtej e tutje Hieronin nën
mbrojtje,

shpresat, dëshirat ia plotësoftë.

Vërma ti veshin, o Muzë, dhe i këndo
Dinomedit

kuadrigën¹⁾ ngadhënjimtare; harenë e fito-
res së korrur prej prindit
dhe djali e ndien; pra për mbretin e Etnës
t'ia themi një himni.

1) Karrocë me katër kuaj

STROFË Këtë qytet për atë e themeloi Hieroni
t'lrirë siç e deshën hyjnitë
e sipas ligjeve të normës së Hilit, se fis' i
Pamfilit
dhe i Heraklidëve që rrëzë shpateve t'Taigetit banon,

do t'u përmbahet përherë
ligjeve dorike t'Egimit.

T'ardhur nga bjeshkët e Pindit ata drejt e
n'Amikël u ngulën, fqinj shumë bujarë t'tin-
daridëve kuajbardhë ata dolën e nisi t'lulëzo-
jë lavdia e heshtave t'tyre

ANTISTROFË ZEUS, ti o plot i fuqishëm, qyteta-
rëve e mbretërve

mu përmbi ujra t'Amenës
namin u dhëntë po ky fat edhe qoftë një nam
i përjetshëm.

E ai prijs me një ndihmë veç prej teje
t'birin drejtoftë dhe polemit,
paqen i faltë e bashkimin.

Jepe pëlqimin, Kronid; kështu vigmës tirrene
e finikase
freri t'i vihet; e panë kokëfortët, kërdrinë e
anijeve

të tyre pranë Kumës dhe panë
EPOD ç'vuajtje pësuan të dërrmuar prej të parit të
sirakuzanve,
i cili nga anijet e shpejta rininë ia mbyti ndër
dallgë
dhe së rëndës robëri ia shkuli prej thonjve
Heladën.

Lavdinë do t'këndoj që Athinës i dha Sala-
mina,

edhe betejën e Spartës
në Citeron, ku Medi harkpërkuluri u thye;
por dhe për djem t'Dinomedit lypet një himn,
se ndër ujra të pastra t'Himarës treguan tri-
mëri kur armikun e shtypën;

STROFË po fole me masë dhe po dite shumë fjalë
të përmbledhësh

shkurt, atëherë dhe më i paktë
del përgojimi i botës, për shkak se mërzia e
tepruar

shpresat e ngutshme i topit
e zemrat smirzeza helmohen,
t'mirat e t'tjerëve kur ndiejnë. Por prapë,
më mirë të t'kenë zili se sa të t'mëshirojnë.

Veprës së mirë mos iu ndaj, mbaje drejt ti
mbi popuj timonin
dhe gjuhën mos e farkëto, jo, kurrë
në kudhër gënjeshtare.

ANTISTROFË Një fjalë e paurtë dhe e vogël, po
t'doli prej goje,

e madhe do t'duket;
ti drejton, dhe ke shumë'dëshmitarë për të
keq e për të mirë.

Po deshe gjithmonë të përmendesh,
qëndro n'ato hove fisnike;
mos rri pa u treguar zemërbardhë
ashtu siç bën barkatari, dhe ti hapja erës,
pra, velat.

Mos të gënjejnë, o vëlla, mashtrimet
mikluese,
sepse vetëm nami i vetmi që mbetet pas
vdekjes,

EPOD u thotë historianëve e poetëve si rrojtën ata
që u zhdukën.

Jo, nuk është shuar ende e Krezit mirësia, e
jo, as burrëria;
por Falarin, atë zemërgurin, që digjte njerë-
zimin në demin e bronzitë e mbulon përgjith-
monë nami i zi.

Në qestet e veta as djelmoshat
n'të ëmbëlën shoqëri s'i këndojnë. Pra e mi-
ra më e parë patjetër janë veprat e hijshme
dhe nami e dyta. Kush i ndeshi e rroku të
dyja, më të lartën kurorë ka fituar.

NEMEA E TRETË

PËR FITOREN E ARISTOKLIDIT NË PANKRAC

STROFË Muze e nderuar, që nënë je për ne, në
kremtimin e shenjë të Nemesë, eja, t'lutem,
n'këtë ishull dorik të Egjinës mikpritëse, se
n'brigje

të Asopit po të presin të rinjtë,
që këngët i thurin si mjalti dhe zërin ta ndi-
ejnë mezi ç'presin:
kanë etje të ndryshme, po, veprat e ndry-
shme.

Fitorja ndër lojra lakmon më fort këngën,
shoqëruese besnike kurorash, lavdish.

ANTISTROFË Oh, bëj që mendja ime begatshëm të
reshet!

O bija e atij zoti që vran edhe kthjell, të lu-
tem pra, thuaja
një himni të lartë, se me zërin,
me lirën e tyre bashkohem.

I këndshëm për Zeusin do t'jetë lavdërimi i
asaj toke, ku s'pari
banuan mirmidonët, fuqinë e të cilëve
Aristoklidi nuk desh ta turpëronte;

në ndeshje të t'rreptit pankrac s'u ligsthua;
E P O D të forta qenë rrahjet që mori, por n'lugjet e
thella t'Nemesë si bar ngushëllimi ato patën
një këngë që këndon ngadhnjimin.
N'qofshin dhe veprat të hijshme siç është
edhe vetë aq i hijshëm
i Aristofanit djaloshi,
në kulm të lavdisë ka arritur. Nuk është pu-
në e lehtë

kalimi i një deti t'parratur më tej se ato
shtylla t'Heraklit,
STROFË të cilat ky zot dhe heroi dëshmitare

t'shkëlqyeshme
t'lundrimit më t'skajmë i vendosi, si mbyti
përbindshat

e fuqishëm të detit dhe të fshehta

ca rryma zbuloi dhe arriti

cakun e fundit për njerzit, të tokës shënoi
kufirin.

N'ç'drejtim, ti moj zemër, ma shpure anijen?

Pranë Eakut sill Muzën, pranë fisit të tij.

Është koha t'lëvdohet lulja e drejtësisë, njer-
zit e mirë.

ANTISTROFË. Njeriu s'i duron lavdërimet e
t'tjerëve, përpiqu e
kërko në shtëpi: aty mund t'i këndosh diç-
kaje fisnike!

Kënaqet mes trimave t'moçëm

mbreti Peleu, që pat'shkukur të potershmen
heshtë e që fill ashtu vetëm, pa ushtri, push-
toi edhe Jolkun,

me mund të madh shtiu n'dorë dhe Tetidën.

E i fortë Telamoni, shoqëruar me Jolaun,
 ia shoi jetën atij Laomedontit,
 E P O D e tok me të Amazonet i theu, ato gra me
 hark bronzi,
 e kurrë e kurrë frika, nënshtruesja e njerë-
 zimit, s'ia mposhti guximin.
 Rëndë peshon njeriu që në gjak e ka vlerën
 t'rrenjosur;
 një i ditur, me mendje të turbullt,
 që lakmon herë një send herë një tjetër, me
 hap t'pasigurt
 marshon nëpër sprova t'mëdha me një shpirt
 që s'ia del dot qëllimit.

STROFË N'shtëpinë e Filirës jetonte flokarti Akili;
 fëmijë pra na ishte, por ç'punë madhështore
 ai bënte kur flakte
 atë thepin e shkurtër të heshtës;
 edhe një hapi me erërat,
 luanët edhe derrat e egër i vriste dhe vrap ia
 çonte
 centaur Kronidit gjahun që ende dridhej;
 shtatë vjeç ish atëherë; sa fort u mahnitën
 Artemi dhe Atena syapatrembur

ANTISTROFË se si ky djalë pa qen e pa leqe
 mashtruese shumë drera po therte, pse
 n'vrap i kalonte. Tregojnë ata t'vjetrit,
 me sa kam dëgjuar, një ngjarje të tillë:
 Kironi i urtë nën strehën shkëmbore
 Jasonin e rriti dhe Asklepin, të cilit atë artin
 dorëlehtë
 t'farmakëve ia mësoi; martoi dhe të bijën
 e hijshme t'Nereut edhe djalin ia rriti

trim t'fortë, se ia mbrujti atë shpirt me vir-
tyte;

E P O D kështu që, i shtytur prej erërash t'furishme
të Trojës, vikamën dhe zhurmën e heshtave
t'frigjve t'përballte edhe duart t'i përleshte
me armët etiope
e n'mendje t'shestonte mënyrën
se si ai Memnoni, zotëria i tyre, kushuriri
i fortë i Helenit, t'mos kish mundësi n'atdhe
të rikthehej.

STROFË Dhe që këtej rrezaton deri larg e eakideve
lavdia;
gjaku yt është, o Zeus, edhe të tuat patjetër
këto lojra,
që i kremton himni im, duke kënduar
me zë të rinisë një festë vendi.
Dhe Aristoklidit shumë hije i ka kënga, se-
pse këtij ishulli lavdinë ia shtoi dhe me spro-
va t'shkëlqyeshme

Tearit t'Apollit ia ngriti shumë namin.

Vetë prova na thotë se kush është më i zoti,
ANTISTROFË i riu ndër të rinj edhe burri ndër
burra edhe plaku
ndër pleq; këto janë të tri fatet që vijnë një
pas një në farën e njerëzve; por jeta e
gjatë

mëson dhe virtytin e katërt:

t'kënaqesh me ç'ke përpara. Nga to asgjë s'i
mungon

Aristoklidit. Mik, të falem!

Këtë mjaltë t'shkartisur me qumësht si bora,
ta sjell t'shkumëzuar me vesë, është një pije
që do t'jehojë me këngën e fyejve eolianë.
E P O D Vonë, kjo dhuratë. Por, ndër shpesë është
e shpejtë shqiponja, që së largu
vëzhgon dhe ato kthetra ia ngul vetëtimë
presë së vet të përgjakur,
ndërsa laraskat kërkëllisin, kullosin në fushat
e ulta.

Me dashje të fronbukurës Klio,
drit' e lavdisë, çmim për guximin që korr
aq fitore,
për ty sot shkëlqeu nga Nemea, Megara e
Epidauri!

OLIMPIKJA XIV

PËR FITOREN E ASOPIKUT NË VRAP

Ju, që në short patët ujrat e Cefisit
dhe që trevën e atllarëve t'mrekullueshëm
e keni për banesë,
o moj Harite,
mbretëresha t'famshme t'Orkomenit t'ndritur,
ju mbrojtëset e t'lashtëve minianë,
dëgjomëni, një fjalë unë kam me ju!
Vërtet, çdo gjë, që e ëmbël edhe e këndshme
është për mortarët,
bashkë me ju lindet:
dhe dituria edhe bukuria
edhe lavdia, sepse as perënditë,
pa qenë t'shenjtat Harite, s'mund t'u prijnë
vallëzimeve e gostive,
por, mbarështruese
të çdo veprimi n'qiell,
fronat vendosur
afër harkartit Apolon pitianit,
i bëjnë nderime
lavdisë s'amshuar t'Atit olimpik.
O Agllai e nderuar,

o Eufrosinë këngëdashëse,
bijat e më të fuqishmit
nga perënditë, dëgjomëni tani,
dëgjo dhe ti, o Tali melodidashëse,
që këtë kortezh po e vren
n'ecje me hap t'ngadalshëm
n'gëzimin e triumfit:
erdha t'këndoju sipas mënyrës lidie,
me himne, Asopikun,
sepse qytet i Minies sot falë teje
na doli fitimtar n'olimpiadë.
Vrapo, e Jehonë, n'shtëpinë me mure t'zéza
të Persefonës; sillja, pra, babait
të këtij djali lajmin e shkëlqyer
dhe thuaj se ndër luginat e përmendura
të Pisës ky djalosh i kurorëzoi
flokët e vet me flatrat
e çmimeve t'lavdishme.

PITIKJA VII

KUSHTUAR MEGAKLEUT TË ATHINËS FITUES NË KUADRIGË

STROFË — Madhështorja Athinë është preludi
më i bukur për t'hedhur themelet
e himnit që do t'u këndojë
atllarëve të fisit të fortë
të alkemenidëve.
Ku ka një atdhe,
ku ka një shtëpi më të ndritur
n'Heladë, që unë ta përmend?

ANTISTROFË — Dhe në të vërtetë
n'të gjitha qytetet seç ziejnë lavdërimet
për qytetarët e Erekteut!
Janë po ata, o Apolon,
që në Pitonin hyjnor
të mrekullueshme e ngritën
atë banesën tënde.
Mal zemra më bëhet
për pesë ngadhënjimet istmike
dhe për një fitore t'shkëlqyer
ndër lojrat olimpike të Zeusit

EPOD dhe për të dy fitoret e Kirrës.
Janë tuajat, o Megakle,
edhe të të parëve tuaj;
dhe kjo e tanishmja fitore
zembrën ma mbush me gëzim;
ç'e do, se unë ndjej hidhërim
kur shoh se zilia është shpërblimi
i veprave kaq të lavdishme.
Dhe në të vërtetën
thuhet se fatbardhësia,
kur për shumë kohë lulëzon,
i sillka njeriut dhe njërin dhe tjetrin.¹⁾

1) Njërin dhe tjetrin, gëzimin dhe hidhërimin.

ISTMIKJA VI

KUSHTUAR STREPSIADIT NGA TEBA FITUES NË PANKRAC

STROFË O e lumtura Tebë,
prej cilës lavdi kombëtare të hershme
ka mbetë e kënaqur më fort zemra jote?
Mos ndoshta kur nxore në dritë
Dionisin flokgjatin, që i rri mu përbri
Demetrës bronzshungullueses,
apo kur prite më të lartën hyjni,
që zbriti si një shi krejt i artë
mu n'mes të natës

ANTISTROFË dhe u ndal bash te dyert e Amfi-
trionit ta bënte Alkmenën nënë t'Herakliut?
apo kur këshillat e urta t'Tiresit
të dhanë kënaqësi?

Apo kur të kënaqi kujazbutësi Jolau?
Apo dhe spartanët luftëtarë të palodhur?
Apo kur n'britmat e tmerrshme të luftës
e prapse Adrastin, të mbetur fillkat

EPOD pa gjithë ata shokë,
drejt e n'Argosin kuajdashës?
apo atherë kur vendose
n'themele t'sigurta

koloninë doriane t'lakedemonëve
dhe kur egejdët pasardhësit e tu
pushtuan Amiklën
sipas t'parafolmes pitiane?
Mirëpo mirësia¹⁾ e vjetër dremitet
dhe njerëzit harrojnë

STROFË çdo gjë që s'ka arritur
në lulen më t'lartë t'diturisë
së bashku me valët e ndritura
të poezisë.
Epo aherë me një himn
melodiëmbël lartoje
dhe Strepriadin, sepse bash te Istmi
ai korri fitoren n'pankrac:
i tmerrshëm n'fuqi,
i hijshëm në pamje,
ai është i pajisur me një virtyt
po aq të lartë
sa dhe hijeshia e tij.

ANTISTROFË Ai sot po lëshon vezullime,
falë Muzave kaçurrelzeza;
kurorën e vet ai e ndau
me dajën²⁾, që ka po atë emër,
dhe Aresi, ai shqytabronzi,
atij i dha vdekjen,

1) Mirëpo mirësia etj. Një mirëbërësi e vjetër edhe mund të harrohet; vetëm poezia duke i kënduar asaj e mban të gjallë dhe thujse e përjetëson.

2) Kurorën e vet ai e ndau etj. — Një dajë i Strepriadit, i quajtur po me këtë emër, qe, edhe ai atlet; dhe u vra duke luftuar për mbrojtjen e vendit.

por burrave t'fortë në shkëmbim
përballë u rri nderi!
Dhe kushdo le ta dijë fare mirë
se ai që n'shtërngatën e luftës,
atdhen'e dashur duke mbrojtur,
mban larg prej tij stuhinë e përgjakshme
EPOD kërدينë duke bërë nëpër radhët armike,
i gjallë dhe i vdekur
ai u sjell qytetarëve
më t'madhen lavdi.
Edhe ti, ore djalë i Diodotit,
pas shembullit të trimit Meleagër,
pas shembullit t'Hektorit
dhe t'Amfiaraut,
dhe shpirt në lule t'rinisë,

STROFË n'përleshjen e radhëve të para,
mu aty ku trimat e fortë
po rrekeshin n'valën e luftës
dhe ishin n'kulmin e shpresës.
Dhe unë e ndjeva një dhimbje,
që s'thuhet me gojë.
Mirëpo i tokës Qarkuesi,
tani, mbasi iku shtërgata,
ma hapi kohën e kthjellët.
Një të stolisë me kurorë
flokët e mi, unë këngën do nis.
Mos më prufshin hyjnitë ziliqare
asnjë turbullim

ANTISTROFË në harenë e përditshme,
ndërsa n'qetësi vazhdoj rrugën
drejt pleqërisë edhe orës fatale.
Të gjithë të njëlojtë e kemi vdekjen

por fatin jo njëlloj
e n'rast se ndokush ka synime ambicioze,
është tepër i vogël që t'arrijë
në banesën e bronztë të hyjnive,
se Pegasi, me flatra, e përmbys
EPOD të zotin Belerofontin,
që donte të vinte n'banesën qiellore
dhe t'futej n'këshillin e Zeusit,
se fatin e një të padrejti
e pret një mbarim shumë i hidhur.
O ti Loksi
sillna kurorë me lule të bukura
me flokë të praruar,
edhe në garat e tua pitike!

EPIGRAME

HERES

Velin e shenjtë t'kaçurrelave,
ty, o Herë, ta kushtoi Alkibia,
kur në nusi virgjërore arriti.

(Arkiloku)

EPITAFI I TIMADES

Ky hi është i Timadës,
që vdiq pa arritur në nusi,
dhe e priti skuta e errët e Persefonës.
Si vdiq ajo, vetë shoqet,
të gjitha
me hekur sapo të mprehur,
prenë e mbi varr i vunë
flokët e bukur të kokës.

(Safo)

EPITAFI I PELAGONIT

Peshkatarit Pelagon
i kushtoi baba Menisk
një lopatë edhe një rrjetë
si kujtim t'një jete s'shkretë.

(Safo)

PËR NJË SHTATORE TË AFËRDITËS

Kjo është e Qipridës selia.
Asaj ia pat'ënda gjithmonë ta kundronte
detin e ndritshëm nga bregu,
lundrimin t'ua bënte të ëmbël detarëve;
e detin përreth e zë frika
kur sheh këtë statujë vezulluese.

(Anita)

PËR NJË BULKTH DHE NJË GJINKALLË

Një bulkthi, bilbilit të brazdave,
dhe një gjinkallë, banores së lisave,
varr të përbashkët u ngriti Miroja,

lot virgjërore duke derdhur, e shkreta,
sepse dy lodrat e saja ia mori
Hadi i pamëshirshëm.

(Anita)

MBI VARRIN E VET

O shtegtar, po lundrove
drejt Mitilenës plot valle të bukura,
që ndezi lulen e hireve të Safos,
thuj se e deshën fort muzat
atë që toka e Lokridës e lindi,
dhe, me t'marrë vesh se Noçidë e kam emrin,
nisu dhe shko.

(Nosida)

LE TË PIMË SA TË JEMI GJALLË

Pi, Asklepiad! Ç'janë këta lot? Ç'të ndodhi?
Qiprida, tekansosja, s'të ka lidhur
ty vetëm, edhe Erosi i inatosur
s'ka mprehë shigjeta e hark vetëm për ty

Pse bëhesh hi e pluhur për së gjalli?
Ta pimë lëngun e Bahtit krejt safi.
Ja, po agon. A mos po presim, vallë,
të rrimë e të shikojmë gjithnjë kandilin
që na vë n'gjumë? Të pimë plot me hare.
S'do shkojë shumë kohë dhe ne, more derëzi,
do të pushojmë n'të madhen errësirë.

(Asklepiadi)

MBI VARRIN E SAONIT

Këtu ka rënë në gjumë të shenjtë Saoni,
djalë i Dikonit, akantas.
Mos thuj «Vdiq» për njeriun e mirë.

(Kalimaku)

MINJVE

Ikni kasollje,
o minj t'errësirës!
Magjia e Leonidës
nuk mund t'i ushqejë
as minjtë jo, e shkreta;

se plaku s'do tjetër,
kur ka bukë e kripë.
Këtë mënyrë të jetuari
të parët na lanë.
Pse pra, ti o llupës,
rrëmon te kjo vrimë,
ndërsa nuk po mundesh
t'shijosh një thërrime,
tepruar n'tryezë?
Ik në shtëpi të tjera,
se bosh është imja —
atje do të ngopesh.

(Leonida)

ËSHTË KOHË PËR LUNDRIM

Është kohë për lundrim!
Dhe Dallëndyshja, llaptare ia behu,
me të dhe i ëmbli Zefiri.
Lulëzojnë dhe livadhet;
ka heshtë edhe deti, i trazuar më parë
prej dallgësh, prej erës së madhe.
Detar, ngre spirancën e zgjidhi litarët,
e me vela të nderë bjeri detit...

(Leonida)

MALL

Larg tokës s'Italisë këtu unë dergjem,
larg atdheut tim Tarentit.
Kjo më lëndon më tepër se sa vdekja;
kjo qenka jeta e pajetë e endacakëve.
Po pas të gjitha t'zezave
kam një kënaqësi:
të paktën m'deshën muzat,
pra nami Leonidës nuk i humbi.
Për mua janë një dëshmi dhuntitë e muzave,
dersa të ndrisë ky diell!

(Leonida)

VERË E TRISHTIM

Mbush gotën e thirre dhe një herë,
dhe një herë dhe një herë Heliodorën;
thirre, edhe t'ëmbilin emrin e saj
përzieje me verë të kulluar.
E mua më vër një kurorë,
të zhytur ndër erëra;
të jetë ajo e djeshmja, n'kujtimin e saj.
A sheh? Po vajton trëndafili i dashnorëve,
se atë po e shikon diku gjetkë
e jo këtu n'krahët e mi.

(Meleagri)

LULE PËR HELIODORËN

Do t'bëj një tubë me t'bardhën manushaqe
dhe me t'njomin narcis do t'bëj një tubë
bashkë me mersina;
do t'bëj një tubë dhe me zambakët e qeshur,
edhe me t'ëmbilin krok¹⁾ do t'bëj një tubë;
e, për më tepër,
do t'bëj një tubë dhe me zymbyl të purpurt;
do t'bëj një tubë edhe me trëndafila,
që fort i duan dashnorët;
kështu që nëpër tëmblla t'Heliodorës,
t'erëndshmes kaçurrele,
flokët e dredhur hijshëm
t'spërkaten plot me lule
nga kjo kurorë.

(Meleagri)

MBI VARRIN E HELIODORES

Unë lot ty po të fal dhe aty nën dhé,
o Heliodorë, relike t'dashurisë atje në Had,
lot të një vaji t'kotë;
e përmbi varr aq fort të përlotuar

1) Safrani

unë po liboj: n'kujtim të dashurisë,
n'kujtim të miqësisë;
sepse unë Meleagri
ty, që dhe ndër të vdekur je aq e ëmbël,
me mall të qaj, me mall,
stoli e kotë atje tek Akeronti.
Medet, ku m'iku njomza e zemrës sime?
E mori Hadi, e mori,
e lulen e kërthnestë e shëmtoi dheu.
Por unë, o Tokë, ushqyese e gjithësisë,
në gjunjë të lutem,
mbështillma lehtë të gjorën
në gjirin tënd, o nënë!

(Meleagri)

PËR NJË FTUJË

I shkreti ti, o Tirs!
Ç'fiton që i shkrin me lot bebet e syrit?
Pse qan? Ty t'iku ftuja,
filizi i bukur, t'iku drejt në Had;
egër ndër thonj të vet e shqeu ujku.
Ç'fiton dersa s'ka mbetë shenjë as nishan
prej saj? Ajo u zhduk.

(Teokriti)

PËR NJË VOGËLUSHE TË SHKRETË

Kjo çupë shkoi para kohe,
ende shtatë vjeç, në Had,
përpara shoqesh tjera,
e mori malli t'shkretën
për vëllanë, kërthi veç njëzet muajsh,
të cilin e shijoi mortja mizore.
Aman, moj pëllumbeshë, regjë me mjerime,
sa t'zeza të llahtarshme
i vuri njerëzisë hyu para këmbëve!

(Teokriti)

SHËNIME

KUSHTRIM Fatitë (Parkat), figura mitologjike që mendohej se kishin në dorë fijen e jetës së njeriut.

SALAMINA — Janë tri fragmente të ndryshme të elegjisë «Salamina». Sipas pohimit të Plutarkut, kjo elegji përbëhej prej 100 vargjesh. Athina për një kohë shumë të gjatë kishte hyrë në grindje me Megarën për zotërimin e Salaminës. Mirëpo në fund athinasit hoqën dorë dhe doli një ligj, sipas të cilit kushdo që guxonte të bënte propagandë për ripushtimin e Salaminës do të dënohej me vdekje. Thuhet, pra, se vetë Soloni u shti i marrë dhe, si i tillë, u paraqit në agora i veshur si udhëtar dhe deklamoi këto vjersha. Vetë Soloni mori komandën e ekspeditës dhe Salamina u shti në dorë prej athinasve.

Folegandri dhe Sikini: dy ishuj të vegjël, shkëmbo-rë në Egje — poeti pranon të jetë më mirë banor i një ishulli shkëmbor se sa nënshtetas athinas, por me turp.

NJË GOSTI DIJETARËSH — *Krater* — kupë. *Libacion* — derdhja e verës mbi altar ose në tokë në nderim të hyjnive gjatë një ceremonie. — *Titanë, viganë, centaurë* — qenie mitologjike.

LARG ATDHEUT-Eurota, lumë i Lakonisë (Spartës)

PO AFROHET STUHIA — *Glauku*, ndonjë mik i poetit. — *Majat e Gyrenjve*, shkëmbinj pranë ishullit Mikono, në arkipelagun e Cikladeve (deti Egje).

LARG PASURISË — *Gigi*, mbret i Lidisë, pasanik i madh.

PAS NJË FATKEQËSIE Prej një stuhie ishin mbytur në det shumë bashkëqytetarë, ndër të cilët edhe kunati i Arkilokut. Poeti në këto vargje do të ngushëllojë edhe mikun e vet Perikliun.

LIKAMBIT Likambi poetit i ka dalur fjale, nuk do t'i japë më të bijën, Neobulën. Arkiloku shtihet sikur nuk dëgjoji mirë se ç'i tha Likambi edhe e pyet: Si the, si the? Ti për nder s'i paske trutë në vend.

GRATË Është një fragment i poemthit satirik «Gratë», Poeti gratë i ndan në disa kategori. Ato rrjedhin prej gjallesash të ndryshme. Natyrisht poetit i pëlqejnë vetëm gratë që kanë dalë prej bletës.

LUTJE-Hermesi, biri i Zeusit dhe i Majës, kishte lindur në një shpellë të malit Cilon, në Arkadi. Hermesi ishte hyu i tregtarëve dhe i vjedhësve. *Staterë*, monedhë ari.

ARMËT TË GATSHME PËR MBROJTJEN E ATDHEUT – Përshkruhet një sallë ku shkëlqejnë armë e pajime ushtarake, të gatshme për t'u ngjeshur në shtat në rast kushtrimi, për mbrojtjen e atdheut. – **Ares**, zoti i luftës. – *Kalcidike*, shpata të punuara në Kalcidikë, Eube, që ishin me nam.

LE TË PIMË SA TË JEMI GJALLË. – *Akeronti*, lumë i Avernit, nëpër të cilin kalojnë të vdekurit për matanë. – *Sizifi*, i biri i Eolit, me dredhinë e vet arriti ta lidhte Mortjen. Për një kohë askush nuk vdiste më. Mirëpo Mortjen e zgjidhi Aresi, hyu i luftës dhe ajo e përplasi Sizifin në ferr. Sizifi prapë iku dhe erdhi mbi tokë. Në fund e vrau Tezeu. Pasi vdiq një herë e mirë, Sizifi u dënua të çonte vazhdimisht lart një shkëmb të madh, i cili sapo arrinte në majë të malit, prapë rrokullisej poshtë dhe prapë Sizifi do t'i jepte lart deri në majë. Kjo ngjitur e zbripte e gurit do të vazhdonte për amshim. – **Siri**, ylli më i bukur dhe më i shkëlqyer, që bashkë me diellin e verës sjell vapën më të madhe.

AFËRDITËS – Përfytyrohet Afërdita mbi koçinë e praruar, që e tërheqin fluturim harabela të bukur. – *Bindja*, hyjnesha që i shërbente Afërditës.

TI MOJ MËZJA PREJ TRAKIE – *Anakreonti* në rini jetoi në Traki. Dihet se Trakia ishte e përmendur për

racën e bukur të kuajve. Poeti e parafytyron vashën, që gjithnjë i rri larg, si një mëze të bukur e të shkathët. — *Dhe rreth caqeve të vrapimit, gjatë shtegut, ku zhvillohen gara në vrap.*

Ç'TU BËJ THINJAVE. — Motit, për të shfaqur dashurinë, hidhej molla ose bëhej shkëmbim mollësh ndërmjet dy dashnorëve. — *Të mahitem, të luaj.*

NATË E QETË-Rrëmore, shpat-thikë.

SIKUR TË ISHA QERIL — Thuhej qysh prej kohëve të vjetra se qerilin, mashkullin e pulëbardhave, kur plaket dhe s'është i zoti të fluturojë, e mbartin mbi valët e detit ndër krahë vetë pulëbardhat femra. Poeti ia ka zili atij shpendi. Edhe Alkmani do të dëshironte të hidhej, në valle, midis vajzave.

KUPA E DIELLIT — Janë gjashtë vargje të Gerionej-dës. Sipas mitologjisë, Dielli i bie Oqeanit tej përtej mbi një kupë në trajtë lundre. Dielli këtë lloj lundre ia dha Herakliut që të mund ta arrinte Gerionin në një ishull midis Oqeanit. Këto vargje na përshkruajnë çastin në të cilin Dielli ulet në kupë, që ia ktheu Herakliu, dhe ky i fundit futet në pyll.

VAJTIMI I DANAES — Ky fragment është pjesë e një kënge të quajtur «threnos» (vajtim). Danaen, të bijën e Akrizit, mbretit të Argut, e kish futur i ati në burg, sepse orakulli i kishte thënë se po të lindte prej saj një djalë, ky do të vriste gjyshin. Mirëpo Zeusi zuri merak në Danaen dhe ia afrua në trajtën e shiut të artë. Prej tyre lindi Perseu. Atëherë Akrizi për të zhdukur nënë e djalë, i futi në një arkë, të cilën e hodhi në det. Pikërisht këtu zë fill fragmenti. — *Dedaliane*, arkën e kish ndrequr dora e Dedalit.

TEZEU — Është i vetmi ditiramb në formë dialogu, që na ka mbetur nga bota e lashtë. Tezeu, djali i Egjeut, mbretit të Athinës, ishte rritur nga e ëma Etra në Megarë, pra as nuk e njohte të jatin. Në moshën gjashtëmbëdhjetëvjeçare u drejtua për Athinë dhe gjatë udhëtimit bëri mrekullira me trimërinë e vet. Kur djaloshi i afrohet Athinës, i ati, mbret Egjeu, pa ditur se kush ishte ai njeri i çuditshëm, jep kushtrimin për të rrokur armët. Këtu fillon dialogu midis Egjeut dhe Korit. Kori pyet për

ç'arsye ra boria për të rrëmbyer armët. Egjeu përgjigjet se një «belaxhi» po i afrohej Athinës. Prapë kori do të dijë nëse ky njeri i çuditshëm është në krye të ndonjë ushtrie apo vetëm. «Dy burra ka pas» ia kthen Egjeu, të cilit nuk i vete mendja se ai ishte pikërisht i biri. Në fund, sapo arrin Tezeu në Athinë, i ati menjëherë e njuh, ndonëse pas gjashtëmbëdhjetë vjetësh. — *Gojë-tumbakja*, bori me gojë ose grykë bronzi. — *O ti bir i Pandionit e i Kruczës*, O Egje. — *Sini*, kusar i madh, lidhte udhëtarët te maja e dy pishave, që ai vetë i përkulte me sa fuqi kishte e pastaj prapë i lëshonte dy majat, kështu që trupit i udhëtarëve çahej dysh. *Kronid Lete dhelëkundës* — Poseidoni, hyu i detit. — *Skironi* detyronte udhëtarët t'ia lanin këmbët dhe pastaj me një shqelm i hidhte në det, ku i hante një breshkë ujëse. — *Cercioni*, atlet, u dilte para udhëtarëve, përleshje me ta dhe i vriste. — *Prokusti* — kapte udhëtarët dhe i shtrinte në shtratin e vet. Ata që kalonin masën e shtratit, i shkurtonte ndërsa ata që ishin më të shkurtër se shtrati i zgjaste me çekanin e tmerrshme të t'et, Polipemonit. Kur Prokusti mori vesh se Tezeu me gjithë sa u përmendën sipër i kishte dërrmuar fare, hodhi çekanin, pasi e humbi shpresën se do ta shtrinte në shtrat edhe Tezeun. — *Në njërin me burrë*, — në Tezeun; *thotë se ...* kasneci tregon se kush është ky njeri. — *Lemni*, ishull i Hefetsit, hyu i zjarrit.

PITIKJA E PARË — Pindari e fillon odën me një himn drejtuar lirës, e cila me melodinë e vet pushton çdo qenie të natyrshme e të mbinatyrshme, vetëm armiqtë e Zeusit dridhen prej asaj melodie, si p.sh. përbindëshi Tifon, që digjet nën malin e Etnës, e mbasi pikërisht rrëzë Etnës Hieroni themeloi qytetin e ri po me emrin Etna, Pindari i uron të mbarën e të mirën për kohën e ardhshme. Etna do të ketë fatin të shohë herë pas here ngadhënjime të reja të themeluesit të vet Hieronit dhe të birit Dinomedit. Këtu përmenden në mënyrë të veçantë të dy fitoret e famshme që korri Hieroni në Kumë dhe në Himerë. *Latoidin*, Apoloni. — *Peridet*, Muzat. — Titanin Tifon Zeusi e pati gjuajtur me rrufe dhe e pati varrosur në Etna, sepse ai kishte dashur të ngjitej për shkallësh drejt e në qiell. — *Cilicia*, krahinë bregdetare në Azinë e Vogël. — *Gurra kastalje*,

burim në Parnas, kushtuar Apolonit dhe muzave. — «*E bëftë të harrojë edhe dhimbjet*», d.m.th. dhimbjet fizike, se Hieroni ishte i sëmurë. — *Filokteti*, djali i Peantit, trashëgoi prej Herakliut shigjetat e ashtuquajtura «të pagabueshme» në shenjë. Mirëpo gjatë udhëtimit për në Trojë Filoktetin e kafshoi një gjarpër në njërën këmbë, e cila zuri të lëshonte një erë aq të rëndë sa Agamemnoni, sipas këshillës së Odiseut, dha urdhër që Filokteti të zbriste në ishullin e Lemnit, ku heroi jetoi dhjetë vjet krejt i vetmuar e me dhimbje të forta. Kur grekët u bindën se Troja nuk mund të pushtohej pa shigjetat e Herakliut, atëherë Odiseu dhe Neoptolemi shkuan në Lemn, morën Filoktetin me vete në Troje, ku heroi, si u shërua prej Makaonit, vrau Paridin dhe Troja u pushtua. Kështu edhe Hieroni, ndonëse i sëmurë, sipas shembullit të Filoktetit, zbriti në fushën e nderit, luftoi dhe doli fitues. — *Dhe mendjemadh*, ky mendjemadh duhet të jetë ndonjë nga prijësit e Kumës i cili, megjithëse krenar, u detyrua t'i përulëj Hieronit, t'i kërkonte ndihmë kundër sulmit të etruskëve. — *Heronjtë gjysmëhyjnjë* duhet të jenë Odiseu dhe Neoptolemi. — *Një djalë shigjetar i Peantit*, d.m.th. Filokteti. — *Dinomedi*, djali i Hieronit. — *Hili*, i biri i Herakliut, i shpuri dorianët në Peloponez. — *Norma e Hilit* d.m.th. ligjet dorike. Poeti thotë se Hieroni themeloi qytetin e Etnës sipas ligjeve dhe institucioneve dorike. Dorianët ndaheshin në tri fise: hili-dë, pamfilë, e dimanë (hilidët pasardhës të Hilit, pamfilë e dimanë, bijtë e Egimit). Dorianët, të ardhur nga Greqia Veriore, banuan së pari ndërmjet Tesalisë, Lokridës dhe Focidës, pastaj nën udhëheqjen e heraklidëve shkuan në Peloponez e nga bjeshkët e Pindit zunë vend në Tajget. — *Amikla*, qyteti i Lakonisë. — *Amena*, përrua që rrjedh rrëzë Etnës. — *Ai prijs*, Hieroni. — *Polemi*, populli. — *Vigma tirrene*, britma, sulmi i tirrenasve dhe i fenikasve le të dështojë para fuqisë së Hieronit. Pranë Kumës tirrenasit u thyen keqas prej Hieronit. — *Ç'vuajtje* etj. I pari i sirakuzanëve, Hieroni, dërgoi flotën e vet në ndihmë të kumanëve dhe beteja mori fund me disfatën e armikut. Hieroni me fitoren e vet shpëtoi Heladën jo vetëm me betejën e Kumës por edhe me atë të Himerës. Me fjalën Heladë këtu kuptohet «Magna Graecia», (kolonitë greke të

Italisë Jugore). *Citeroni*, mal në Beoti. — *Për djem të Dinomedit...* Djemtë e Dinomedit në luftimin pranë Himerës dolën ngadhënjyes mbi kartagjenasit. — *Krezi*, mbret i Lidisë, i përmendur për urtësi — *Falari*, tiran i Agrigjentit, i famshëm për mizori, kishte ndërtuar një dem bronzi, krejt zgavërr përbrenda. Nën barkun e kësaj kafshe prej metali ndizte zjarr kurse brenda fuste të dënuarit, që vdisnin ndër torturat më çnjerëzore.

NEMEA E TRETË. Këtë ode Pindari ia kushton Aristoklidit të Egjinës, fitimtar i pankracit (përleshje trup me trup) në Neme. Aristoklidi me fitoren e vet — thotë poeti — arriti kulmin. Mirëpo në këtë rast Pindari e sheh më të arsyeshme të përmendet Peleu, që është pikërisht prej Egjine, ashtu edhe Akili, prandaj Aristoklidin fitimtar e krahason me këta dy heronjtë e fundit. — *Nemea*, luginë në Argolidë, ku zhvilloheshin lojërat, të ashtuquajtura *Nemee*; — *Egjina*, ishull ndërmjet Peloponezit dhe Atikës, — *Asopi*, lumë, ku të rinjtë, që do të këndojnë për Aristoklidin, presin pikërisht Muzën. — *Mirmidonët*, popull i Tesalisë, që kishte për mbret Akilin. — *Djaloshi i Aristofanit*, Aristidi — *Kalimi i një deti...* Përshkruhen rragimet e famshme të Herakliut. Ky çau në dy pjesë malin e Kalpit dhe të Abdilës (në Gjibraltari), që u quajtën shtyllat e Herakliut. Si ky hero, që arriti kulmin e guximit në lundrim, ashtu edhe Aristoklidi, në pankrac, preku kulmin e forcës. *Pellgjet e ulëta*, me sa duket, Sirti, — *Anijen* (metaf.); fantazinë; *Eaku*, mbret i Egjinës, i ati i Peleut dhe i Telamoni, prandaj kryefis i eakidëve. — *Jolku*, qytet në Tesali, u pushtua prej Peleut. — *Telamoni*, mbret i Egjinës. — *Jolau*, Herakliu. — *Laomedonti*, mbret i Trojës. — *E kundër*, i shkoi pas Herakliut kundër amazonëve, gra luftëtare. — *Filira* e ëma e Kironit. — *Centauri Kronid*, Kironi, përbindësh, nga maja e kokës e deri në gjoks njeri, dhe prej gjoksi e poshtë kalë. Qe edukues i Akilit. — *Sa fort u mahnitën...* Artemisi e Atena çuditeshin se si ai d.m.th. Akili... — *Jasoni*, hero, — *Asklepi*, Eskulapi. — *E bija e Nereut*, Teti. — *Djalin*, Akilin — *Dersa e shtytur*, (nënkuptohet) Akili, *Memnoni*, djali i Titonit dhe i Aurores, u dërgua prej t'et, mbret i Egjiptit dhe i Etiopisë, në ndihmë të trojanëve. Në rrethimin e Trojës Memnoni vrau Antilokun, të birin e Nestorit,

pastaj dhe ai vetë u vra prej Akilit. — *Teari*, tempull në Egjinë, kushtuar Apolonit (pitik). *I riu ndër të rinj...* Pindari tri etapat kryesore të jetës së njeriut, f.m.th. rininë, burrërinë, pleqërinë, i konsideron si tri shorte, tri funksione, ndër të cilat njeriu, me anë përpjekjesh, mund të dalë fitues mbi moshatarët e vet: i riu ndër të rinj, burri ndër burra, plaku ndër pleq, e këtu, me sa duket, është fjala për fitore nga ana fizike. Mirëpo poeti thotë se veç këtyre ekziston edhe e katërta, më tepër morale d.m.th. matura. — *Këtë mjaltë...* Pindari krahason himnin, që i kushton Aristoklidit, me një kupë qumësht të ëmbëlsuar me mjaltë — *Vonë*, poeti rrëfen haptazi se kjo poezi ka humbur aktualitetin nga shkaku se himnin po ia drejton fituesit Aristoklid. Mirëpo Pindari, me një parafytyrim të fuqishëm, shpëton nga kjo situatë e ngushtë, duke e krahasuar veten me shqiponjën, e cila, kur e heton në largësi prenë e vet, ndonëse larg, prapëseprapë arrin ta kapë vetëtimthi, ndërsa laraskat (ndoshta poetët e tjerë) kullosin e gërthasin atje poshtë në fushë. — *Klio* — Muza e historisë. — *Megara*, qytet mbi Istmin e Korintit. *Epidauri*, qytet në Argolidë.

OLIMPIKJA XIV Cefisi, lumë në Greqi. *Orkomeni*, qytet në Beoti, qendër e popullit të vjetër të quajtur minianë. — *Haritet*, të Tri Hiret, personifikime të bukurisë: Aglaia, Eufrosina dhe Talia, — *Minia*, kryeqendra e minianëve. — *Persefona* (Proserpina), mbretëresha e Ferrit. — *Pisa*, qytet i Elidës pranë Olimpisë.

PITIKJA VII — Erekteu, hero, kryefis i atikëve. — *Pitoni*, lokalitet pranë Delfit, ku ishte orakulli i Apolonit. *Ismike*, lojra që zhvilloheshin pranë Korintit. *Kirra*, qytet i Fokidës.

ISTMIKJA VI Demetra — hyjnesha e drithërave, e bujqësisë dhe e qytetërimit; merr epitetin bronzshungulluese, sepse kjo hyjneshtë brodhi nëpër gjithë botën duke kërkuar të bijën dhe duke u rënë ca veglave prej bronzi, që jepnin oshëtimë të madhe. *Më të lartën hyjni*, Zeusin. Sipas legjendës, Zeusi një natë zbriti nga Olimpi në trajtë shiu të artë te pragu i shtëpisë së Amfitrionit, pastaj mori krejt pamjen e këtij, iu afrua gruas së tij Alkmenës dhe nga bashkimi i tyre lindi Herakliu.

Tiresi – Parafolës i përmendur i Tebës. *Adrasti* – mbret i Argosit, priti si mik Polinicin të cilin e dëboi nga Teba vëllai i tij Eteokli. Atëherë Adrasti u ngrit të luftonte kundër Eteoklit. Mirëpo mu në luftën e parë mes argivëve dhe tebanëve, Adrasti u rthye dhe u detyrua të kthehej i mundur në Argos. *Sipas t'parafolmes pitiane* – Orakulli i Delfit u dha tebanëve të kuptonin se ata duhej ta pushtonin Amiklën me ndihmën e familjes së egidëve. Kur kaluan në Lakemonë, ata u pritën mirë, i adoptuan ligjet e asaj krahine dhe kështu i dhanë fund ndërmarrjes së tyre. *Djali i Diodotit*, vetë Strepsiadi, *Meleagri*, hero, u dallua për guximin e madh në ndërmarrje të ndryshme si p.sh. në vrasjen e derrit të egër të Kalidonit. *Amfiarau*, parafolës i përmendur, një nga argonautët. *I tokës Qarkuesi*, Poseidoni, hyu i detit. *Pegasi*, kali me fletë. Belerofonti, hero mitologjik, djalë i Poseidonit, e përdori këtë kalë për t'u përleshur me Kimerën, përbindësh me gjoks dhe me kokë luani, me bark dhie e me bisht gjarpri, dhe e vrau. Pas kësaj fitoreje Belerofontit iu rrit mendja dhe, kaluar mbi Pegasin, mori guximin të ngjitej në qiell për të shkuar drejt te Zesusi, mirëpo Pegasi e rrokullisi të zotin. *Loksia*, epitete i Apolonit.

EPITAFI I TIMADËS – *Timada*, vashë që vdiq e re. Shoqet, në nderim të vashës së vdekur, prenë flokët e vet mbi varrin e saj.

PËR NJË BULKTH DHE NJË GJINKALLË – *Miroja*, një vogëlushe,

MBI VARRIN E VET – *Mitilena*, ishull në Egje, atdheu i Safos. – *Lokrida*, vendlindja e Nosidës.

MBI VARRIN E HELIODORËS – I kërthnestë, i freskët.

PËR NJË FTUJË – Tirsi, emër bariu.

TREGUESI I LËNDËS

Parathënie	3
*) HESIODI	
Nga vepra «Punët dhe ditët»:	
Gara të mira e të këqija	23
Punë e jo gjyqe	24
Dhuna dhe drejtësia	30
30 mijë ruajtësit e drejtësisë	32
E keqja dhe virtyti	34
Të mençur e budallenj	34
Puna dhe përtacia	36
Mos vidh	38
Bujqësia	39
*) KALINI	
Kushtrim	51
*) TIRTEU	
Vdekja me nder kapak floriri	53
Këngë marshimi	54
*) FOKILIDI	
Gjykime	55

* SOLONI

Salamina	56
Një këshillë athinasve	57
Vetë ju e keni fajin	59

* KSENOFANI

Një gosti dijetarësh	60
----------------------------	----

* TEOGNIDI

Vulë autenticiteti	62
Të zezat e varfërisë	63
Një pyetje Zeusit	64
Larg atdheut	65
Klithma e kurrillave	66
Mallkim	67
Pavdekësia	68

* ARKILOKU

Një këshillë zemrës	69
Dukja të gënjen	70
Po afrohet stuhia	71
Larg pasurisë	72
Pas një fatkeqësie	73
Likambit	74

* SEMONIDI

Gratë	75
-------------	----

* HIPONAKTI

Lutje	77
-------------	----

* ALKEU

Armët të gatshme për mbrojtjen e atdheut	79
Le të pimë sa të jemi gjallë	80

Në piskun e vapës	81
Kujdes, o anije	82
Vdiq tirani	82
Gjatë stuhisë	83

Y SAFO

Afërditës	84
Pasion dashurie	86
Mbrëmjes	87
Hëna e plotë	87
Lamtumirë	88
Kroi	89
Qipridës	89
Mes shoqeve	89
Natë e vetmuar	90
E bukura e largët	90
Mollë e harruar	92

ANAKREONTI

Fuqia e dashurisë	93
Fytafyt me dashurinë	94
Moj mëzja prej Trakie	95
Ç't'u bëj thinjave	96
Gosti gazmore	97

ALKMANI

Natë e qetë	98
Sikur të isha qeril	99
Kënga e thëllëzave	99

STESIKORI

Kupa e diellit	100
----------------------	-----

IBIKU	
	Kënga e pranverës 101
	Dashuria në pleqëri 102
✕ SIMONIDI	
	Vajtimi i Danaes 103
	Dëshmorëve të Termopilave 105
	Virtyti 106
	Të rënë në Termopila 106
BAKILIDI	
	Lavdi paqes 107
	Tezeu 108
✕ PINDARI	
	Pitikja e parë 111
	Nemea e tretë 118
	Olimpikja e katërbëdhjetë 123
	Pitikja e shtatë 124
	Istmikja e gjashtë 127
EPIGRAME	
✕ ARKILOKU	
	Herës 131
✕ SAFO	
	Epitafi i Timadës 131
	Epitafi i Pelagonit 132
ANITA	
	Për një shtatore të Afërditës 132
	Për një bulkth dhe një gjinkallë 132
NOSIDA	
	Mbi varrin e vet 133

ASKLEPIADI

Le të pijmë sa të jemi gjallë 133

KALIMAKU

Mbi varrin e Saonit 134

LEONIDA

Minjve 134

Është koha për lundrim 135

Mall 136

MELEAGRI

Verë e trishtim 136

Lule për Heliodorën 137

Mbi varrin e Heliodorës 137

TEOKRITI

Për një ftujë 138

Për një vogëlushe të shkretë 139

Gmimi Lekë 2.50